



# FLETORJA ZYRTARE

E

## REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 22

2000

Korrik

### PËRMBAJTJA

Ligj nr. 8635, datë 6.7.2000	Për ratifikimin e Konventës Civile "Për Korrupsionin".....	1063
Ligj nr.8637, datë 6.7.2000	Për Policinë Elektrike.....	1070
Ligj nr.8638, datë 13.7.2000	Për aderimin në "Protokollin e Vilniusit të 3 qershorit 1999, që përmban modifikimin e "Konventës për transportet ndërkombëtare hekurudhore (COTIF), të 9 majit 1980".....	1073
Ligj nr.8639, datë 13.7.2000	Për ratifikimin e "Kartës për Organizimin dhe Funkcionimin e Qendrës Rajonale të Iniciativës së Bashkëpunimit për Europën Juglindore (Qendra Seci) për luftën kundër krimet ndërkufitar".....	1078

Ligj nr.8640, datë 13.7.2000	Për ratifikimin e "Protokollit të Dytë Shtesë të Marrëveshjes për Krijimin e Forcës Shumëkombëshe të Paqes të Europës Juglindore".....	1080
Ligj nr.8641, datë 13.7.2000	Për ratifikimin e "Protokollit VI të "Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore".....	1084
Ligj nr.8642, datë 13.7.2000	Për ratifikimin e "Konventës Europiane "Për Shtypjen e Terrorizmit".....	1087
Vendim i Kuvendit Nr.446, datë 13.7.2000	Për miratimin e Dekretit të Presidentit të Republikës për lirimin e zotit Arben Demeti nga detyra e Ministrit të Punëve Publike.....	1092
Vendim i Kuvendit Nr.447, datë 13.7.2000	Për miratimin e Dekretit të Presidentit të Republikës për lirimin e zotit Ilir Zela nga detyra e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit.....	1092
Vendim i Kuvendit Nr.448, datë 13.7.2000	Për miratimin e Dekretit të Presidentit të Republikës për lirimin e zotit Ilir Panda nga detyra e Ministrit të Drejtësisë.....	1092
Vendim i Kuvendit Nr.449, datë 13.7.2000	Për miratimin e Dekretit të Presidentit të Republikës për lirimin e zotit Luan Hajdaraga nga detyra e Ministrit të Mbrojtjes.....	1093
Vendim i Kuvendit Nr.450, datë 13.7.2000	Për miratimin e Dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Ilir Gjoni Ministër i Mbrojtjes.....	1093
Vendim i Kuvendit Nr.451, datë 13.7.2000	Për miratimin e Dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Ilir Zela Ministër të Punëve Publike.....	1094
Vendim i Kuvendit Nr.452, datë 13.7.2000	Për miratimin e Dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Arben Imami Ministër të Drejtësisë.....	1094
Vendim i Kuvendit Nr.453, datë 13.7.2000	Për miratimin e Dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Ndre Legisi Ministër Shteti pranë Kryeministrit.....	1095
Dekret nr.2699 Datë 19.7.2000	Për lënie të shtetësisë shqiptare.....	1095
Vendim i KM Nr.353, datë 7.7.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.190, datë 3.5.1995, "Për zbatimin e ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 "Për Statutin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar".....	1096

Vendim i KM Nr.354, datë 7.7.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.217, datë 5.5.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për Kontrollin Financiar".....	1098
Vendim i KM Nr.361, datë 14.7.2000	Për shpërndarjen me koeficient pjesorë të vlerave financiare, kreditorëve të shoqërisë "Silva", sh.p.k, në administrim, me të ardhurat e realizuara nga shitja e asetëve.....	1099
Vendim i KM Nr.362, datë 14.7.2000	Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit "K".....	1100
Vendim i KM Nr.364, datë 14.7.2000	Për trajtimin e punonjësve, që shkurtohen nga zbatimi i Marrëveshjes së koncesionit, për uzinën e ferrokromit, Elbasan dhe për minierat e kromit Përrenjas dhe Pojskë.....	1104
Vendim i KM Nr.365, datë 14.7.2000	Për trajtimin e punonjësve që shkurtohen nga ristrukturimi i industrisë së bakrit.....	1105
Vendim i KM Nr.374, datë 14.7.2000	Për rritjen e pagës minimale, në shkallë vendi.....	1106
Vendim i KM Nr.375, datë 14.7.2000	Për disa ndryshime në vendimin nr.437, datë 3.9.1993, të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të Tatimeve".....	1107
Vendim i KM Nr.376, datë 14.7.2000	Për rritjen e pagave të gjyqtarëve dhe të prokurorëve.....	1108
Vendim i KM Nr.377, datë 14.7.2000	Për disa ndryshime në vendimin nr.194, datë 22.4.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagave të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar".....	1110
Vendim i KM Nr.378, datë 14.7.2000	Për disa ndryshime në vendimin nr.393, datë 3.9.1992, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore".....	1112
Vendim i KM Nr.379, datë 14.7.2000	Për disa ndryshime në vendimin nr.185, datë 16.4.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat dhe shtesat mbi pagë të ushtarakëve të shërbimit pyjor".....	1120
Vendim i KM Nr.380, datë 14.7.2000	Për disa ndryshime në vendimin nr.358, datë 28.7.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve të doganave".....	1121
Vendim i KM Nr.381, datë 14.7.2000	Për disa ndryshime në vendimin nr.440, datë 9.9.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për strukturën dhe pagat e punonjësve të Policisë së Ndërtimit".....	1122
Vendim i KM Nr.382, datë 14.7.2000	Për rritjen e nivelit të pagesës së papunësisë.....	1124

Vendim i KM Nr.384, datë 14.7.2000	Për disa ndryshime në vendimin nr.112, datë 18.3.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994, "Për sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë".....	1125
Vendim i KM Nr.385, datë 14.7.2000	Për një ndryshim në vendimin nr.381, datë 20.5.1996, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin e Statutit të Invalidit".....	1126
Vendim i KM Nr.386, datë 14.7.2000	Për rritjen e Pensioneve Suplementare.....	1126
Vendim i KM Nr.387, datë 14.7.2000	Për Rritjen e Pensioneve.....	1127
Udhëzim nr.3 datë 14.7.2000	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.1, datë 18.3.1999, të Këshillit të Ministrave "Për zbatimin e vendimit nr.112, datë 18.3.1999, të Këshillit të Ministrave,"Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, "Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë".....	1129

**L I G J**  
**Nr.8635, datë 6.7.2000**

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS CIVILE “PËR KORRUPSIONIN”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Konventa civile “Për korrupsionin””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2696, datë 17.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**

**KONVENTA CIVILE PËR KORRUPSIONIN**

**HYRJE**

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, shtete të tjera dhe Komuniteti Europian, nënshkruese të kësaj Konvente;

Duke ditur që qëllimi i Këshillit të Europës është të arrijë një unitet më të madh ndërmjet anëtarëve të tij;

Të ndërgjegjshëm për rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit;

Duke theksuar që korrupsioni përfaqëson një rrezik të madh për shtetin ligjor, demokracinë dhe të drejtat e njeriut, pastërtinë dhe drejtësinë sociale, që pengon zhvillimin ekonomik dhe rrezikon funksionimin e drejtë dhe të duhur të ekonomisë së tregut;

Duke njohur pasojat e dëmshme financiare të korrupsionit ndaj individëve, kompanive dhe shteteve, si dhe ndaj instituconeve ndërkombëtare;

Të bindur në rëndësinë për një ligj civil që të kontribuojë në luftën kundër korrupsionit, veçanërisht duke bërë të mundur që njerëzit e dëmtuar të marrin kompensim të drejtë;

Duke kujtuar konkluzionet dhe rezolutën e 19-të (Maltë, 1994), 21-të (Republika Çeke, 1997) dhe 22-të (Moldavi, 1999) të Konferencave të Ministrave të Drejtësisë të vendeve të Europës;

Duke pasur parasysh Programin e Veprimit kundër korrupsionit të miratuar nga Komiteti i Ministrave në nëntor 1996;

Duke pasur gjithashtu parasysh studimin e fizibilitetit mbi hartimin e një konvente mbi kompensimet civile të pasojave që vijnë nga veprimet korruptive, të miratuar nga komiteti i ministrave në shkurt 1997;

Duke u mbështetur në rezolutën (97) 24 mbi 20 Parimet Drejtuese për Luftën kundër korrupsionit, miratuar nga Komiteti i Ministrave në nëntor 1997, në sesionin e tij të 101-të, në

Rezolutën (98) 7 që autorizonte miratimin e Marrëveshjes së Pjesëshme dhe të Zgjeruar për të ngritur “Grupin e Shteteve kundër korrupsionit”, miratuar nga Komiteti i Ministrave në maj 1998, në sesionin e tij të 102-të dhe në Rezolutën (99)5 për ngritjen e Greko(GSHKK), miratuar më 1 maj 1999;

Duke kujtuar Deklaratën Përfundimtare dhe Planin e Veprimit të miratuar nga Kryetarët e Shteteve dhe Qeverive të vendeve anëtare të Këshillit të Europës në samitin II në Strasburg në tetor 1997,

Bien dakord si më poshtë:

## KAPITULLI I MASAT QË DUHEN MARRË NË RANG KOMBËTAR

### Neni 1 **Qëllimi**

Secila palë pjesëmarrëse duhet të parashikojë në ligjin kombëtar rregullime efektive për personat që dëmtohen si rezultat i veprimeve korruptive, t’u japë atyre mundësi të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre, duke përfshirë dhe mundësinë për t’u kompensuar për dëmin.

### Neni 2 **Përcaktimi i korrupsionit**

Për qëllimet e kësaj Konvente, fjala “korrupsion” merr kuptimin e të kërkuarit, ofrimit, dhënies ose pranimit drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë të një mitëmarrje ose çdo lloj tjetër avantazhi ose përfitimi që deformon kryerjen e çdo detyre ose sjellje të kërkuar nga pranuesi i mitëmarrjes, për pasojë dhe të avantazhit e përfitimit të padrejtë.

### Neni 3 **Kompensimi i dëmtimit**

1. Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar, për personat që janë dëmtuar si rezultat i korrupsionit, të drejtën për të inicuar një veprim në mënyrë që të marrin kompensim të plotë për një dëmtim të tillë.

2. Një kompensim i tillë mund të mbulojë dëmtimin material, humbjen e përfitimeve dhe humbje jomonetare.

### Neni 4 **Besueshmëria**

1. Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar plotësimin e kushteve të mëposhtme për të kompensuar të dëmtuarit:

i. i akuzuari ka kryer ose ka autorizuar aktin e korruptimit, ose ka dështuar në ndërmarrjen e hapave të duhur për të parandaluar aktin e korruptimit;

ii. akuzuesi ka pësuar dëmtimin; dhe

iii. ka një lidhje shkakësore midis aktit të korrupsionit dhe dëmit.

2. Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar, kur disa të akuzuar janë të mundshëm të dëmtojnë të njëjtën veprimtari korruptive, ata do të jenë përgjegjës së bashku dhe në mënyrë të ndarë.

### Neni 5 **Përgjegjësia e shtetit**

Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar procedurat e duhura për personat që

janë dëmtuar si pasojë e një veprimi korruptiv nga zyrtarët e tij gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, për të kërkuar kompensim nga shteti ose në rastin e një pale joshitetërore, nga autoritetet zyrtare të palës.

#### Neni 6

#### **Harresa kontribuese**

Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet të brendshëm, që kompensimi të reduktohet ose të mos lejohet sipas rastit, kur i dëmtuari nga gabimet e veta ka ndihmuar dëmtimin ose keqësimin e tij.

#### Neni 7

#### **Kufizimi në kohë**

1. Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar që ecuria e përmirësimit të dëmtimit të jetë për një periudhë jo më të shkurtër se tre vjet nga dita që personi që e ka pësuar nga dëmtimi për t'u ndërgjegjësuar ose të bëhet i ndërgjegjshëm për dëmtimin e kryer ose kryerjen e veprimit korruptiv dhe të përcaktimit të personit përgjegjës. Megjithatë, ecuri të tilla nuk do të fillojnë pasi të ketë përfunduar kufizimi kohor i jo më pak se 10 vjet nga data e kryerjes së aktit korruptiv.

2. Ligjet e palëve që rregullojnë shtyrjen ose ndërprerjen e kufizimit kohor, kur është i përshtatshëm do të zbatohet për periudhën e parashikuar në paragrafin 1.

#### Neni 8

#### **Vlefshmëria e kontratave**

1. Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar që çdo kontratë ose pjesë kontrate për korrupsion të anulohet dhe të jetë e pavlefshme.

2. Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar mundësinë që të gjitha palët në kontratë, leja e të cilëve është shpërdoruar nga një veprim korruptiv, të kenë mundësinë e apelimit në gjykatë për ta shpallur të pavlefshme dhe në kundërshtim me të drejtën e tyre për t'u ankuar për dëmtimet.

#### Neni 9

#### **Mbrojtja e punonjësve**

Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar mbrojtjen e duhur ndaj çdo sanksioni të pajustificuar ndaj punonjësve të cilët kanë arsye të dyshojnë për korrupsion dhe që këtë dyshim ia paraqesin personave përgjegjës ose autoriteteve.

#### Neni 10

#### **Llogaritë dhe kontrolli**

1. Secila palë në ligjin e vet kombëtar do të marrë masat e nevojshme që llogaritë vjetore të kompanive të kontrollohen dhe të japë një paraqitje të drejtë të situacionit financiar të kompanisë.

2. Për parandalimin e veprimeve korruptuese, secila palë do të parashikojë në ligjin e tij të brendshëm kontrollin për të konfirmuar që llogaritë vjetore paraqesin një gjendje të drejtë dhe të saktë të situacionit financiar të kompanisë.

#### Neni 11

#### **Marrja e provave**

Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet të brendshëm procedura efektive që në një proces civil të merren prova që kanë dalë nga një veprim korruptiv.

Neni 12  
**Masat interim**

Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet të brendshëm dispozita për këto gjykata në mënyrë që të mbrojnë të drejtat dhe interesat e palëve gjatë procesit civil të një veprimi korruptiv.

KAPITULLI II  
**BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE MONITORIMI I ZBATIMIT**

Neni 13  
**Bashkëpunimi ndërkombëtar**

Palët do të vendosin bashkëpunim efektiv për çështjet që kanë të bëjnë me procedurat civile të çështjeve të korrupsionit, sidomos për shërbimin e dokumenteve, marrjen e provave nga jashtë, juridiksionin, njohjen dhe forcimin e gjykimeve të vendeve të tjera dhe koston e gjykimit në përshtatje me dispozitat përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare mbi bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet civile dhe tregtare në të cilën ato janë nënshkruese, si dhe në përputhje me ligjin e tyre të brendshëm.

Neni 14  
**Monitorimi**

Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GSHKK – GRECO) do të monitorojë zbatimin e kësaj Konvente nga palët.

KAPITULLI III  
**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Neni 15  
**Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për t'u nënshkruar nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës, shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në diskutimin e saj dhe për Komunitetin Europian.

2. Kjo Konventë duhet të ratifikohet, pranohet dhe miratohet. Instrumentet e ratifikimit, pranimi dhe miratimit do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

3. Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pasardhës pasi përfundon periudha tremujore nga data në të cilën katërmbëdhjetë nënshkruesit janë shprehur për Konventën sipas dispozitës në paragrafin e parë. Çdo vend nënshkrues, që nuk është anëtar i Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) në kohën e ratifikimit, pranimi ose miratimit, do të bëhet automatikisht anëtar në datën që Konventa hyn në fuqi.

4. Përsa i përket nënshkruesit, i cili ka shprehur për të, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit vijues pas mbarimit të periudhës tremujore pas datës që kanë shprehur pranimin për t'u bashkuar konventës sipas dispozitës së paragrafit 1. Çdo vend nënshkrues, që nuk është anëtar i Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) në kohën e ratifikimit, pranimi ose miratimit do të bëhet automatikisht anëtar në datën që Konventa hyn në fuqi.

5. Çdo modalitet për pjesëmarrjen e Komunitetit Europian në Grupin e Shteteve kundër korrupsionit (GRECO) do të përcaktohet, në rast se do të jetë i nevojshëm, me anë të një marrëveshjeje me Komunitetin Europian.

Neni 16  
**Njohja e Konventës**

1. Pas hyrjes në fuqi të Konventës, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pas konsultimeve me palët pjesëmarrëse në Konventë, mund të ftojë shtetet joanëtare të Këshillit dhe që nuk kanë marrë pjesë në diskutimin e saj, të atashohen në Konventë pas një vendimi të marrë nga maxhoranca, siç parashikohet në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Europës dhe me votim unanim të përfaqësuesve të palëve anëtare të Komunitetit.

2. Për Shtetin që i atashohet Konventës, ajo hyn në fuqi ditën e parë të muajit që vijon pas prezumimit të periudhës tremujore nga data e depozitimit të instrumentit për atashim pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Çdo shtet që i atashohet Konventës bëhet automatikisht anëtar i GRECO, në rast se nuk është bërë anëtarë në kohën e atashimit, kur respektivisht konventa hyn në fuqi.

Neni 17  
**Rezervat**

Nuk mund të bëhen rezerva për asnjërën dispozitë të kësaj Konvente.

Neni 18  
**Zbatimi territorial**

1. Çdo shtet i Komunitetit European, në momentin e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentet e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose atashimit, mund të specifikojnë territorin ose territoret në të cilat do të zbatohet Konventa.

2. Secila palë mund, që në një datë të mëvonshme, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të zgjerojë zbatimin e kësaj Konvente edhe në territorin tjetër të përcaktuar në deklaratë. Për këto territore Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pasues të periudhës tremujore pas datës së marrjes së një deklaratë të tillë nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Çdo deklaram i bërë sipas dy paragrafëve paraardhës mund, përta i përket territorit të përcaktuar në deklaratë, të tërhiqet me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja bëhet e efektshme ditën e parë të muajit pasardhës të një periudhe tremujore nga data e marrjes së njoftimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 19  
**Marrëdhëniet me instrumentet dhe marrëveshjet e tjera**

1. Kjo Konventë nuk ndikon në të drejtat e fituara që rrjedhin nga instrumentet shumëpalëshe përta i përket çështjeve të veçanta.

2. Palët në Konventë mund të lidhin marrëveshje dy dhe shumëpalëshe ndërmjet tyre për çështje të parashikuara nga Konventa me qëllim për të plotësuar ose forcuar dispozitat e saj ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që përfshin ajo, ose për të mos paragjykuar ndaj objektivave dhe parimeve të kësaj Konvente, të angazhohen për t'i rregulluar këto çështje brenda kuadrit të një sistemi të veçantë me të cilin lidhet në çastin e hapjes së kësaj Konvente për nënshkrim.

3. Kur dy a më shumë palë kanë përfunduar një marrëveshje ose traktat, subjekt i së cilës është përmbajtja e kësaj Konvente ose kanë vendosur marrëdhëniet mbi këtë bazë ato duhet që të zbatojnë këtë marrëveshje ose traktat, ose ta përshtasin konform Konventës aktuale.

Neni 20  
**Amendamente**

1. Amendamentet e kësaj Konvente mund të propozohen nga çdo palë dhe do t'u

komunikohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës shteteve anëtare të Këshillit të Europës, shteteve joanëtare të Këshillit të Europës, që kanë marrë pjesë në diskutimin për këtë Konventë, Komunitetit Europian, si dhe shtetet që ka aderuar ose është ftuar për të aderuar në këtë Konventë, siç parashikohet në dispozitat e nenit 16.

2. Çdo amendament i propozuar nga ndonjë palë do t'i njoftohet Komitetit Europian mbi Bashkëpunimin Ligjor (CDCJ), i cili do t'i paraqesë Komitetit të Ministrave mendimin e tij për amendamentet e propozuara.

3. Komiteti i Ministrave shqyrton amendamentin e propozuar dhe mendimin e paraqitur nga Komiteti Europian mbi Bashkëpunimin Ligjor (CDCJ) dhe, pas konsultimeve me Palët në Konventë që nuk janë anëtarë të Këshillit të Europës, mund të miratojë amendamentin.

4. Teksti i çdo amendamenti miratohet nga Komiteti i Ministrave sipas dispozitës së paragrafit 3 të këtij neni dhe u dërgohet palëve për ta pranuar.

5. Çdo amendament i miratuar sipas paragrafit 3 të këtij neni do të hyjë në fuqi ditën e trembëdhjetë pasi palët kanë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm mbi pranimin përkatës.

#### Neni 21

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Komiteti Europian mbi Bashkëpunimin Ligjor (CDCJ) i Këshillit të Europës do të informojë si për interpretimin ashtu dhe zbatimin e kësaj Konvente.

2. Kur lind ndonjë mosmarrëveshje midis palëve, qoftë për interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, do të kërkohet zgjidhja e mosmarrëveshjes me negociata ose mjet tjetër paqësor, sipas zgjedhjes së tyre, përfshi këtu paraqitjen e mosmarrëveshjes pranë Komitetit Europian mbi Bashkëpunimin Ligjor (CDCJ), pranë një gjykate arbitrazhi gjykimi i së cilës është i detyrueshëm për Palët ose në Gjykatën Ndërkombëtare, siç mund të bien dakord palët respektive.

#### Neni 22

#### **Mohimi**

1. Çdo palë mund, në çdo kohë, të dalë nga kjo Konventë me anë të një njoftimi dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Një dalje e tillë është e efektshme ditën e parë të muajit që vijon pas periudhës tremujore nga data e marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

#### Neni 23

#### **Njoftimi**

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit dhe çdo nënshkrues ose palë tjetër në këtë Konventë për:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente sipas neneve 15 dhe 16;
- d) çdo akt tjetër, njoftim ose komunikim që ka të bëjë me këtë Konventë.

Në prani të nënshkruesve, me autorizimin përkatës, nënshkruaj këtë Konventë.

Nënshkruar në Strasburg, nëntor 1999, në anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet identike, në një kopje e cila do të depozitohet në arkivin e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'ia transmetojë kopjet e vërtetuara çdo shteti anëtar të Këshillit të Europës, shteteve joanëtare të cilat kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj Konvente, Komunitetit Europian, si dhe çdo shteti që ftohet për të aderuar në të.

**L I G J**  
**Nr.8637, datë 6.7.2000**

**PËR POLICINË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Neni 1

Policia elektrike krijohet si organ ekzekutiv i specializuar për kontrollin e zbatimit të legjislacionit për administrimin dhe përdorimin e energjisë elektrike në sektorin shtetëror dhe privat nga personat fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Shqipërisë.

Neni 2

Policia elektrike është në varësinë e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe përbëhet nga Drejtoria e Policisë Elektrike dhe degët e saj në prefektura (qarqe).

Neni 3

Policia Elektrike ka këto kompetenca:

a) Ushtron kontroll për zbatimin e legjislacionit përkatës në strukturat që merren drejtpërdrejtë me administrimin dhe përdorimin e energjisë elektrike.

b) Ushtron kontroll për mbrojtjen e rrjetit elektrik dhe të elementeve të tij nga ndërhyrjet e dëmtimeve të kryera pa lejen e ndërmarrjeve shpërndarëse nga persona fizikë e juridikë, vendas e të huaj.

c) Kontrollon procedurën për lidhjet e reja, për dokumentacionin teknik dhe zbatimin e tij.

ç) Kontrollon sistemin matës të energjisë elektrike sa herë e gjykon të nevojshme, por jo më pak se 1 herë në vit.

d) Kontrollon lidhjen dhe zbatimin e kontratës së marrjes të energjisë elektrike.

dh) Hyn në banesë, me pëlqimin dhe në prani të përdoruesit, për të kontrolluar furnizimin me energji elektrike, deri te sistemi matës i energjisë elektrike.

e) Hyn me vendim gjykate në banesë ose në mjedise të njehsuara me të për të kontrolluar instalimet elektrike dhe përdoruesit e energjisë elektrike, pas sistemit matës, kur ka të dhëna se energjia elektrike përvetësohet. Kontrolli në banesë ose në mjediset e njehsuara me të nuk mund të fillojë para orës shtatë dhe pas orës njëzet. Në raste të veçanta titullari i degës së policisë elektrike në prefekturë (qark) mund të urdhërojë me shkrim që kontrolli të bëhet tej këtyre caqeve.

ë) Hyn në çdo kohë në ndërmarrje, institucione, lokale ose vende të tjera, ku ushtrojnë veprimtarinë personat juridikë për të kontrolluar instalimet, sistemin matës dhe përdorimin e energjisë elektrike.

Neni 4

Hyrja e punonjësve të Policisë Elektrike në njësitë, repartet, ndërmarrjet dhe institucionet ushtarake, portet, aeroportet e doganat, bëhet me autorizimin e titullarit të Policisë Elektrike.

#### Neni 5

Punonjësi e Policisë Elektrike, kur gjatë ushtrimit të detyrës vëren dhe zbulon kryerjen e veprave penale, vepron duke fiksuar provat materiale dhe, sipas dispozitave në fuqi, bën kallëzim për ndjekje penale.

#### Neni 6

Policia Elektrike kur vëren shkelje të legjislacionit përkatës, si dhe ato që lidhen me shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “d” të nenit 3 të këtij ligji, nga punonjësit e strukturave që merren drejtpërdrejt me administrimin e energjisë elektrike, i propozon organit të emërtesës masa administrative deri në largim nga puna ose shkarkim nga detyra.

#### Neni 7

Punonjës të Policisë Elektrike pranohen shtetasit që:

- a) kanë kryer shërbimin ushtarak;
- b) kanë arsim të lartë ose të mesëm;
- c) kanë stazh pune jo më pak se 3 vjet;
- ç) nuk janë dënuar me heqje lirie;
- d) kanë figurë të pastër morale.

#### Neni 8

Policia elektrike ka uniformën, shenjat dalluese dhe armatimin, të cilat përcaktohen nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit në bashkëpunim me Ministrinë e Rendit Publik.

#### Neni 9

Policia Elektrike për kryerjen e detyrave të veta bashkëpunon me organet e Policisë së Shtetit, sipas udhëzimeve e marrëveshjeve të veçanta të nxjerra e të nënshkruara nga këto organe.

#### Neni 10

Lidhja elektrike pa kontratë, lidhja elektrike para aparatit matës dhe cënimi i vulave ose dëmtimi i sistemit matës të energjisë elektrike nga konsumatorët familjarë, kur këto shkelje nuk përbëjnë veprë penale, dënohen me gjobë si më poshtë:

- a) Për lidhje abuzive para sistemit matës 5 000 deri në 10 000 lekë.
- b) Për cënim të sistemit matës dhe të vulave të tij 5 000 deri në 12 000 lekë.
- c) Për lidhje në rrjetin elektrik pa kontratë 15 000 deri 20 000 lekë, si dhe shlyerjen e dëmit shkaktuar entit shpërndarës përkatës

Kur këto shkelje bëhen nga subjekte shtetërore ose private dhe fuqia e instaluar është më e madhe se ajo e përcaktuar në kontratë, masa e gjobës të jetë:

- a) Për lidhje abuzive para sistemit matës 10 000 lekë deri në 50 000 lekë.
- b) Për cënim të sistemit matës dhe të vulave të tij 20 000 deri 40 000 lekë.
- c) Për lidhje në rrjetin elektrik pa kontratë 50 000 deri në 100 000 lekë.
- ç) Për shtesë fuqie të instaluar mbi kontratë 5 000 deri 20 000 lekë, si dhe shlyerjen e dëmit shkaktuar entit shpërndarës përkatës.

Në përcaktimin e saktë të vlerës së gjobave, në përshtatje me llojin e shkeljes, madhësinë e fuqisë së instaluar në objektet dhe kohën e vërtetuar me shkelje abuzive, përdoret Tabela e Penaliteteve, e miratuar nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, e cila përmban edhe

dëmin e shkaktuar entit elektrik të shpërndarjes, të miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë së Republikës të Shqipërisë.

Gjoha vendoset nga punonjësit e Policisë Elektrike dhe quhet titull ekzekutiv.

#### Neni 11

Pagesa e gjobës bëhet brenda 5 ditëve. Për çdo ditë vonesë pas plotësimit të këtij, afati vlera e gjobës shtohet 2 për qind mbi vlerën e saj.

#### Neni 12

Kundër vendimit të dënimit me gjobë bëhet ankim me shkrim brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të tij te Drejtori i Policisë Elektrike, i cili duhet të shprehet me shkrim brenda 10 ditëve.

Me shpalljen e vendimit të Drejtorit të Drejtorisë së Policisë Elektrike, bëhet menjëherë ndërprerja e furnizimit me energji elektrike. Subjekteve, që nuk kanë bërë ankim me shkrim, u bëhet ndërprerja e energjisë elektrike.

Kundër vendimit të drejtorit të Drejtorisë së Policisë Elektrike mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 5 ditëve.

#### Neni 13

Kur gjatë ushtrimit të veprimtarisë Policia Elektrike has me përdorues të energjisë elektrike, të cilëve u ka kaluar afati i likuidimit të faturave, në bashkëpunim me filialet elektrike, u bën menjëherë ndërprerjen e energjisë elektrike, deri në likuidimin e debisë.

#### Neni 14

Rilidhja e energjisë elektrike bëhet nga enti elektrik shpërndarës pas paraqitjes së mandatpagesës së gjobës ose debisë nga kundërvajtësi dhe njoftimit të degës së Policisë Elektrike përkatëse.

Nëse rilidhja e energjisë elektrike bëhet nga kundërvajtësi pa likuiduar gjobën ose debinë, të bëhet dyfishimi i gjobës së vendosur dhe ndërprerja përsëri e energjisë elektrike.

Të ardhurat nga gjobat kalojnë 50 për qind në favor të buxhetit të shtetit dhe 50 për qind në favor të Policisë Elektrike, prej së cilës deri në 10 për qind mund të përdoret si shtesë mbi pagë për punonjësit që i realizojnë.

Të ardhurat nga vjelja e debive dhe shlyerjet e dëmeve të realizuara prej Policisë Elektrike, kalojnë 90 për qind në favor të entit elektrik shpërndarës përkatës dhe 10 për qind në favor të Policisë Elektrike.

#### Neni 15

Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit miraton organikën dhe fondin e pagave për Policinë Elektrike, i cili për periudhën deri në fund të vitit 2000 përballohet nga fondet e Koorporatës Elektroenergjetike Shqiptare dhe, pas kësaj periudhe, përballohet nga buxheti i shtetit, si dhe lidhjen e pagës e të shpërblimeve suplementare me realizimin e detyrave.

#### Neni 16

Ligji nr.7619, datë 12.10.1992 “Për inspektoratin e kontrollit të përdorimit të energjisë elektrike”, ndryshuar me ligjin nr.7868, datë 12.10.1994, shfuqizohet.

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2697, datë 6.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**

**L I G J**  
**Nr.8638, datë 13.7.2000**

**PËR ADERIMIN NË “PROTOKOLLIN E VILNIUSIT TË 3 QERSHORIT 1999, QË PËRMBAN MODIFIKIMIN E “KONVENTËS PËR TRANSPORTET NDËRKOMBËTARE HEKURUDHORE (COTIF), TË 9 MAJIT 1980””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Neni 1

Aderimin në “Protokollin e Vilniusit të 3 qershorit 1999, që përmban modifikimin e “Konventës për Transportet Ndërkombëtare Hekurudhore (COTIF), të 9 majit 1980””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2700, datë 19.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**

**PROTOKOLLI**

**I 3 QERSHORIT 1999 QË PËRMBAN MODIFIKIMIN E KONVENTËS NË LIDHJE ME TRANSPORTET NDËRKOMBËTARE HEKURUDHORE (COTIF) TË 9 MAJIT 1980**

(PROTOKOLLI 1999)

Në zbatim të neneve 6 dhe 19, paragrafi 2 të Konventës në lidhje me transportet ndërkombëtare hekurudhore, të nënshkruar në Bernë më 9 maj 1980, që më poshtë do të përmendet “COTIF 1980”, Asambleja e Pestë e Përgjithshme e Organizatës Ndërqeveritare për Transportet Ndërkombëtare Hekurudhore (OTIF) u mbajt në Vilnius nga 25 maj deri në 3 qershor 1999.

- Të bindur në domosdoshmërinë dhe dobinë e një organizate ndërqeveritare që trajton aq sa është e mundur të gjitha aspektet e transportit ndërkombëtar hekurudhor në nivel të shteteve,

- duke konsideruar që OTIF-i është Organizata më e përshtatshme duke pasur parasysh zbatimin e COTIF-it 1980 nga 39 Shtete në Europë, në Azi dhe në Afrikë dhe nga ndërmarrjet

hekurudhore në këto Shtete,

- duke marrë në konsideratë domosdoshmërinë për të zhvilluar COTIF-in 1980 sidomos rregullat uniforme CIV dhe rregullat uniforme CIM, për t'ia përshtatur ato nevojave të reja të transporteve ndërkombëtare hekurudhore,

- duke konsideruar që siguria gjatë transportit të mallrave të rrezikshme në trafikun ndërkombëtar hekurudhor kërkon që të transformohet RID-i në një regjim të së drejtës publike, zbatimi i së cilës nuk varet më nga përfundimi i një kontrate transporti që i nënshtrohet Rregullave uniforme CIM,

- duke konsideruar që ndryshimet politike, ekonomike dhe juridike të ndodhura në një numër të madh të shteteve anëtare pas hyrjes në fuqi të COTIF-it, më 1 maj 1985, do të duhet të jenë motivi për të hartuar rregulla uniforme dhe, në një kuptim të gjerë, detyrime që mbulojnë fusha të tjera të së drejtës që janë të rëndësishme për trafikun ndërkombëtar hekurudhor dhe për t'i përmirësuar ato,

- duke konsideruar që nga nënshkrimi i Konventës më 9 maj 1980 kanë ndodhur ndryshime politike, ekonomike dhe juridike në një numër të madh të Shteteve anëtare që kërkojnë të hartojnë dhe të zhvillojnë rregulla uniforme që mbulojnë fusha të tjera të së drejtës që janë të rëndësishme për trafikun ndërkombëtar hekurudhor,

- duke konsideruar që në bazë të interesave publike të veçanta Shtetet do të duhet të marrin masa më efikase për të mënjeluar pengesat gjatë kalimit të kufijve në trafikun ndërkombëtar hekurudhor,

- duke konsideruar që në interes të transporteve ndërkombëtare hekurudhore është e rëndësishme të aktualizohen konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare shumëpalëshe ekzistuese në fushën hekurudhore dhe, në rast se duhet, për t'i bashkuar ato në Konventë,

Asambleja e Përgjithshme ka vendosur përsa vijon:

#### Neni 1

### **Përmbajtja e re e Konventës**

COTIF 1980 modifikohet sipas përmbajtjes që figuron në aneksin që është pjesë përbërëse e këtij Protokoll.

#### Neni 2

### **Depozituesi provizor**

1. Funksionet e Qeverisë depozituese, të parashikuara në nenet 22 deri 26 të COTIF-it 1980, sigurohen nga OTIF-i, si Depozitues provizor, që me nënshkrimin e këtij Protokoll dhe deri në datën e hyrjes së tij në fuqi.

2. Depozituesi provizor njofton Shtetet anëtare për:

a) nënshkrimet e këtij Protokoll dhe të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose të hyrjes;

b) datën në të cilën ky Protokoll hyn në fuqi në zbatim të nenit 4 të tij dhe siguron funksionet e tjera të Depozituesit të tilla siç janë formuluar në pjesën VII të Konventës së Vjenës të 23 majit 1969 mbi të drejtën e traktateve.

#### Neni 3

### **Nënshkrimi. Ratifikimi. Pranimi. Miratimi. Hyrja**

1. Ky Protokoll qëndron i hapur për nënshkrim nga Shtetet anëtare deri në 31 dhjetor 1999. Ky nënshkrim kryhet në Bernë, pranë Depozituesit provizor.

2. Konform nenit 20, paragrafi 1 të COTIF-it 1980, ky Protokoll i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, të pranimit ose të miratimit depozitohen sa më shpejt që të jetë e mundur pranë Depozituesit provizor.

3. Shtetet anëtare që nuk kanë nënshkruar këtë Protokoll në afatin e parashikuar në

paragrafin 1, si dhe Shtetet, kërkesa e të cilëve për hyrje në COTIF-in 1980 është pranuar me të drejta të plota konform nenit të tij 23, paragrafi i dytë, përpara hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, mund të hyjnë aty duke depozituar një instrument hyrjeje pranë Depozituesit provizor.

4. Hyrja e një Shteti në COTIF-in 1980 konform nenit 23 të tij, kur kërkesa e tij është bërë pas hapjes së nënshkrimeve të këtij Protokolli, por përpara hyrjes së tij në fuqi, vlen si për COTIF-in 1980 ashtu dhe për Konventën në përmbajtjen e Aneksit të këtij Protokolli.

#### Neni 4

#### **Hyrja në Fuqi**

1. Ky Protokoll hyn në fuqi ditën e parë të muajit të tretë që vijon atë gjatë të cilit Depozituesi provizor do t'iu ketë njoftuar Shteteve anëtare depozitimin e instrumentit me të cilin plotësohen kushtet e neneve 20, paragrafi 2 të COTIF-it 1980. Konsiderohen si Shtete anëtare në kuptimin e nenit 20 paragrafi 2 Shtetet, që në momentin e vendimit të Asamblesë së Pestë të Përgjithshme, ishin Shtete anëtare dhe që kanë mbetur Shtete anëtare në momentin në të cilin kushtet për hyrjen në fuqi të këtij Protokolli janë plotësuar.

2. Megjithatë, neni 3 zbatohet duke filluar me hapjen e nënshkrimit të këtij Protokolli.

#### Neni 5

#### **Deklaratat dhe rezervat**

Deklaratat dhe rezervat, të parashikuara në nenin 42 paragrafi 1 të Konventës në përmbajtjen e Aneksit të këtij Protokolli, mund të bëhen ose të paraqiten në çdo moment, edhe përpara hyrjes në fuqi të këtij Protokolli. Ato kanë efekt në momentin e hyrjes në fuqi të këtij Protokolli.

#### Neni 6

#### **Dispozita tranzitore**

1. Jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, Sekretari i Përgjithshëm i OTIF-it thërret Asamblenë e Përgjithshme me qëllim që:

a) të përcaktojë anëtarët e Komitetit Administrativ për periudhën e ardhshme (neni 14 paragrafi 2 shkronja “b”) e COTIF-it në përmbajtjen e Aneksit të këtij Protokolli) dhe, në rast se duhet, për të vendosur fundin e mandatit të Komitetit Administrativ në funksionim;

b) të fiksojë, për një periudhë prej gjashtë vjetësh, shumën maksimale që mund të arrijnë shpenzimet e Organizatës gjatë çdo periudhe buxhetore (neni 14 paragrafi 2 shkronja “e”) e COTIF-it në përmbajtjen e Aneksit të këtij Protokolli) dhe

c) të veprojë në rast se duhet, për zgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm (neni 14 paragrafi 2 shkronja “c”) e COTIF-it në përmbajtjen e Aneksit të këtij Protokolli).

2. Jo më vonë se tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, Sekretari i Përgjithshëm i OTIF-it thërret Komisionin e ekspertëve teknikë.

3. Pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, mandati i Komitetit administrativ, i përcaktuar konform nenit 6 paragrafi 2 shkronja “b” të Konventës 1980, merr fund në datën e fiksuar nga Asambleja e Përgjithshme që duhet të koincidojë me fillimin e mandatit të anëtarëve dhe të anëtarëve plotësues të Komitetit Administrativ të përcaktuar nga ajo (neni 14 paragrafi 2 shkronja “b”) e COTIF-it në përmbajtjen e Aneksit të këtij Protokolli).

4. Mandati i Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Qendrore, në funksion të momentit të hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, përfundon me mbarimin e periudhës për të cilën ai ka qenë emëruar konform nenit 7 paragrafi 2 shkronja “d”) e Konventës 1980. Duke filluar nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Protokolli ai ushtron funksionet e Sekretarit të Përgjithshëm.

5. Po ashtu pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, dispozitat respektive të neneve 6, 7 dhe 11 të COTIF-it 1980 mbeten të zbatueshme përsa i përket:

a) verifikimit të llogarive dhe të miratimit të llogarive vjetore të Organizatës,

- b) fiksimit të kontributeve përfundimtare të shteteve anëtare për shpenzimet e Organizatës,
- c) pagimit të kontributeve,
- d) shumës maksimale që mund të arrijnë shpenzimet e Organizatës gjatë një periudhe pesëvjeçare, të fiksuara përpara hyrjes në fuqi të këtij Protokollit.

Shkronjat “a” deri në “c” i referohen vitit gjatë të cilit ky Protokoll hyn në fuqi, si dhe vitit pasardhës.

6. Kontributet përfundimtare të Shteteve anëtare që nevojiten për vitin gjatë të cilit ky Protokoll hyn në fuqi llogariten mbi bazën e nenit 11 paragrafi 1 i COTIF-it 1980.

7. Me kërkesë të Shtetit anëtar, kontributi i tij i llogaritur në bazë të nenit 26 të Konventës në përmbajtjen e Aneksit të këtij Protokollit është më i madh se ai i duhur për vitin 1999, Asambleja e Përgjithshme mund të caktojë kontributin e këtij Shteti për tre vitet që vijojnë vitin e hyrjes në fuqi të këtij Protokollit duke pasur parasysh parimet vijuese:

a) baza e fiksimit të kontributit tranzitor është kontributi minimal i përmendur në nenin 26 paragrafi 3 ose kontributi i duhur për vitin 1999 nëse ky është më i madh se kontributi minimal;

b) kontributi përshtatet progresivisht në tre etapa deri në maksimum për të arritur shumën e kontributit përfundimtar të llogaritur sipas nenit 26 të sipërpërmendur.

Kjo dispozitë nuk zbatohet ndaj Shteteve anëtare që janë të detyruar për kontribut minimal, që në çdo rast mbetet i nevojshëm.

8. Kontratat e transportit të udhëtarëve e të mallrave në trafikun ndërkombëtar midis Shteteve anëtare, të përfunduara sipas Rregullave uniforme CIV 1980 ose të Rregullave uniforme CIM 1980, mbeten për t’iu nënshtruar Rregullave uniforme në fuqi në momentin e përfundimit të vetë kontratës pas hyrjes në fuqi të këtij Protokollit.

#### Neni 7

#### **Tekstet e Protokollit**

1. Ky Protokoll është përfunduar dhe nënshkruar në gjuhët franceze, gjermane dhe angleze. Në rast divergjence, vetëm teksti frëngjisht është i besueshëm.

2. Me propozim të një nga Shtetet anëtare në fjalë, Organizata publikon përkthime zyrtare të këtij Protokollit në gjuhë të tjera, në kuptimin kur një nga këto gjuhë është një gjuhë zyrtare në territorin e të paktën dy shteteve anëtare. Këto përkthime hartohen në bashkëpunim me shërbimet kompetente të Shteteve anëtare në fjalë.

Në dëshmi të kësaj, të dërguarit fuqiplotë nënshkruen, të autorizuar siç duhet nga Qeveritë e tyre respektive, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në Vilnius, më 3 qershor 1999, në një kopje të vetme origjinale në secilën nga gjuhët franceze, gjermane dhe angleze; këto kopje mbeten të depozituara në arkivat e OTIF-it. Kopje të certifikuara konforme do t’i dorëzohen çdo Shteti anëtar.

#### **L I G J**

**Nr.8639, datë 13.7.2000**

#### **PËR RATIFIKIMIN E “KARTËS PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS RAJONALE TË INICIATIVËS SË BASHKËPUNIMIT PËR EUROPËN JUGLINDORE (QENDRA SECI) PËR LUFTËN KUNDËR KRIMIT NDËRKUFITAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

# K U V E N D I

## I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

### Neni 1

Ratifikohet “Karta për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Rajonale të Iniciativës së Bashkëpunimit për Europën Juglindore (Qendra SECI) për luftën kundër krimit ndërkufitar”.

### Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2701, datë 19.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**

## KARTË PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS RAJONALE TË INICIATIVËS SË BASHKËPUNIMIT PËR EUROPËN JUGLINDORE (QENDRA SECI) PËR LUFTËN KUNDËR KRIMIT NDËRKUFITAR

### 1. OBJEKTIVAT E QENDRËS

1.1. Zhvillimi i marrëdhënieve të punës, efektive dhe të përbashkëta ndërinstitucionale në Qendrën e SECI, si ndërmjet ashtu dhe brendapërbrenda shteteve anëtare.

1.2. Palët ndërmjet ndërlidhësve (liaison officers) kërkojnë në mënyrë kooperative të identifikojnë, parandalojnë dhe luftojnë krimin ndërkufitar, me anë të këmbimit të informacionit dhe dokumenteve, si dhe veprimtarive të tjera të përshtatshme siç parashikohet në Marrëveshje.

1.3. Ndihmë për t'i paraprirë hetimeve doganore dhe kriminale të krimit ndërkufitar.

1.4. Identifikim, studim dhe propozime mbi çështjet që ndikojnë në cilësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve ligjimponuese në nivel rajonal.

### 2. VEPRIMTARIA E PJESËMARRËSVE NË QENDËR

2.1. Veprimtaria e qendrës SECI është në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen SECI mbi “Bashkëpunimin për të parandaluar dhe luftuar krimin ndërkufitar”.

2.2. Qendra SECI përdor procedurat standarte dhe sistemet teknike të ICPO-INILMPOI dhe Organizatës Botërore të Doganave për transmetimin, ruajtjen, kërkimin, rikuperimin dhe analizat e kategorive të pranuar të informacionit që lidhen me krimin ndërkufitar në zbatim të vendimeve të Komitetit të Përbashkët të Bashkëpunimit.

2.3. Qendra SECI organizon takime pune speciale (ad-hoc) ndërkohë që në përshtatshmëri dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar mbështet me kërkesën e tyre, veprimtari operacionale në shtetet pjesëmarrëse.

2.4. Me qëllim emërimin dhe heqjen e ndërlidhësve në Qendrën SECI, palët njoftojnë me shkrim Drejtorin e Qendrës, i cili më pas njofton Komitetin e Përbashkët të Bashkëpunimit.

### 3. VËZHGESIT E PËRHERSHËM

3.1. Statusi i Vëzhguesit të Përhershëm miratohet nga Komiteti i Përbashkët i Bashkëpunimit.

#### **4. STATUSI I QENDRËS**

4.1. Qendra SECI i nënshtrohet marrëveshjes ndërmjet Komitetit të Përbashkët të Bashkëpunimit të Qendrës SECI dhe shtetit mikpritës.

#### **5. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QENDRËS**

##### **5.1. Personeli dhe struktura**

5.1.1. Me dy të tretat e shumicës së Komitetit të Përbashkët të Bashkëpunimit zgjidhet një drejtor, kandidat i shteteve pjesëmarrëse, për të shërbyer për një mandat dyvjeçar, i cili është përgjegjës për menaxhimin dhe organizimin e të gjithë personelit të Qendrës së SECI. Drejtori mund të rizgjidhet për një mandat të dytë dyvjeçar, me dy të tretat e votave të shumicës, ose, me konsensus, për një mandat të tretë dyvjeçar.

5.1.2 Komiteti i Përbashkët i Bashkëpunimit, në bashkëpunim me Drejtorin përcakton Planin Strategjik (vizionin, misionin dhe standardet për realizimin) të Qendrës SECI.

5.1.3. Nga shtetet pjesëmarrëse, në Qendrën SECI, mund të atashohen ndërlidhës (nga dogana, policia dhe atashetë të institucioneve përgjegjëse për kufirin).

5.1.4. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e Qendrës SECI sigurohet nga shteti mikpritës. Personi ndihmës (teknik dhe administrativ) sigurohet nga shteti mikpritës, si dhe kur është e përshtatshme, nga shtetet pjesëmarrëse.

##### **5.2 Financimi:**

5.2.1. Përgjegjësia për financimin e buxhetit të Qendrës SECI përcaktohet nga Komiteti i Përbashkët i Bashkëpunimit.

5.2.2. Sistemi i financimit, planifikimit të buxhetit dhe mbikëqyrja e shpenzimeve përjashtohet dhe miratohet nga Komiteti i Përbashkët i Bashkëpunimit.

5.2.3. Paga e Drejtorit të Qendrës SECI financohet nga buxheti i Qendrës SECI, kufiri i së cilës përcaktohet nga Komiteti i Përbashkët i Bashkëpunimit.

Paga e ndërlidhësve paguhet nga shtetet përkatëse (dërguese).

### **L I G J**

**Nr.8640, datë 13.7.2000**

#### **PËR RATIFIKIMIN E “PROTOKOLLIT TË DYTË SHITESË TË MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E FORCËS SHUMËKOMBËSHE TË PAQES TË EUROPËS JUGLINDORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### **K U V E N D I**

#### **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:**

##### **Neni 1**

Ratifikohet “Protokolli i dytë shtesë i “Marrëveshjes për krijimin e Forcës Shumëkombëshe të Paqes të Europës Juglindore””, nënshkruar më 30 nëntor 1999.

## Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2702, datë 19.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**

### PROTOKOLLI I DYTË SHTESË I MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E FORCËS MULTINACIONALE TË PAQES TË EUROPËS JUGLINDORE

Shtetet palë të marrëveshjes mbi Forcës Ndërkombëtare te Paqes së Europës Juglindore, nënshkruar në Shkup më 26 shtator 1998 dhe Protokollit Shtesë, nënshkruar në Athinë më 12 janar 1999,

Duke riafirmuar angazhimin e tyre ndaj synimeve e parimeve të siguruara në dy dokumentet në fjalë,

Me dëshirën për zhvillimin e mëtejshëm të kooperimit ndërmjet tyre dhe fuqizimin e kapaciteteve ndërhyrëse për rastet emergjente e krizat humanitare,

Me gatishmërinë për krijimin e detajeve dhe amendamenteve në mbështetje në mbështetje të Marrëveshjes në fjalë, kanë rënë dakord sa vijon:

#### Neni 1

Palët krijojnë ndërmjet tyre një Forcë Ndërhyrëse Xheniere (Engenner Task Force) në përputhje me dispozitat që jepen në nenet e mëposhtme.

#### Neni 2

1. Përveç organizimit ekzistues dhe përgjegjësive të Brigadës Ndërkombëtare të Paqes së Europës Juglindore, formohet një Forcë Ndërhyrëse Xheniere (FNXH) e përbërë nga repartet e siguruara nga Palët, rast pas rasti, e përshkruar në Aneksin A bashkëlidhur këtij Protokollit, dhe mbi dispozitat e Nenit 5 të këtij Protokollit, ajo do të jetë në komandimin dhe drejtimin e Brigadës Multinacionale të Paqes të Europës Juglindore.

2. Këndvështrimi i formimit të FNXH-së është t'u sigurojë Palëve kapacitetet ndërhyrëse për rastet emergjente e krizat humanitare.

3. Kjo iniciativë orientohet drejt një asistence civile të shkallës së ulët.

#### Neni 3

1. Kjo forcë do t'i sigurojë mbështetje të menjëhershme popullsisë lokale duke vepruar në mënyrë të pavarur ose bashkë me një organizëm përkatës ndërkombëtar.

2. FNXH do të drejtojë, sipas vendimeve kombëtare, projekte të vogla kooperuese të niveleve të ulëta në fushat e mëposhtme:

- a. Riparime dhe ndërtime të kufizuara rrugësh
- b. Riparime dhe ndërtime të kufizuara urash
- c. Riparime të kufizuara te hekurudhave
- d. Rrëshqitje dheu
- e. Drenazhime
- f. Çminime të kufizuara dhe pastrime të municioneve të paplasura
- g. Në ndonjë fushë tjetër nëse do të bihet dakord.

#### Neni 4

Palët kontribuese do të vënë në dispozicion të FNXH reparte xheniere në varësi të misionit dhe vendimeve kombëtare. Kjo Forcë do të jetë forcë e “gatshme”.

#### Neni 5

Me qëllim realizimin e iniciativës së mësipërme, është rënë dakord të ndiqen fazat e mëposhtme:

1. Faza I (fillestare):

a. Komandim-Kontrolli do të realizohet nga Komandanti i Brigadës Multinacionale të Paqes së Europës Juglindore.

b. Gjatë operacioneve pa kriza, 2 oficerë që do të realizojnë funksionet planizuese, do t'i shtohen seksionit ekzistues të xhenios në Shtabin e Brigadës.

c. Gjatë operacioneve në periudhë krize, do të krijohet një seksion xhenier për krizën, i cili do të drejtohet nga një Oficer Xhenier me gradën n/kolonel, që do të sigurohet nga vendi i Komandantit të Brigadës.

d. Çdo palë, e cila do të marrë pjesë në operacion, do të dërgojë një oficer xhenier në seksionin xhenier të krizës. Kur është e mundur, palët që marrin pjesë në operacion, do të transferojnë oficerat e tyre nga seksioni i xhenios së Brigadës për në seksionin e xhenios për krizat.

2. Faza II

Bazuar në eksperiencën e fituar gjatë fazës I, palët mund të vlerësojnë mundësinë për një alternativë që për këtë Forcë, rregullimet e komandim-kontrollit në varësi të Komitetit Drejtues Politiko-Ushtarak të Brigadës Multinacionale të Europës Juglindore të jetë paralel me Brigadën Multinacionale të Paqes së Europës Juglindore.

#### Neni 6

Palët bien dakord të krijojnë Rrjetin e Informacionit të Krizave (RIK), fillimisht një sistem menaxhimi të Informacionit PFP (PIMS) të orientuar në mbështetje të kësaj Force. Komandanti i Brigadës dhe Palët janë të ftuara të angazhojnë (RIK) për të zgjeruar në maksimum mundësitë praktike të këtij rrjeti.

#### Neni 7

1. Në situatë krize, Kryetari i Komitetit Drejtues Politiko-Ushtarak të Brigadës Multinacionale të Paqes së Europës Juglindore, me propozim të një Pale ose me iniciativën e Tij, mbledh Komitetin Drejtues Politiko-Ushtarak me qëllim diskutimin e situatës dhe formulimin e propozimeve për t'u miratuar nga Ministeriali i Mbrojtjes me qëllim sigurimin e udhëzimeve të posaçme për Komandantin e Brigadës.

2. RIK është krijuar për të shërbyer si burim informacioni dhe linjë komunikimi midis Komitetit Drejtues Politiko-Ushtarak, Komandantit të Brigadës Multinacionale të Paqes së Europës Juglindore dhe Palëve.

#### Neni 8

1. Përveç rasteve kur bihet dakord nga Palët, vetëm ato palë të cilat marrin pjesë në projekte ose operacione krizash, do të jenë përgjegjëse për financimin e tyre. Për më tepër, Komiteti Drejtues Politiko-Ushtarak i Forcës Multinacionale të Paqes së Europës Juglindore do të ekzaminojë resurset alternative të financimit, si janë: Bashkimi Europian, Banka Botërore dhe NATO.

2. Projektet do të drejtohen si stërvipte shumëkombëshe.

## Neni 9

Shtojcat 1, 2 dhe 3 të Aneksit A, dhe Shtojca 2 dhe 4 (faqja 4-4) e Aneksit C të Marrëveshjes për Krijimin e Forcës Multinacionale të Paqes së Europës Juglindore zëvendësohen nga Shtojcat bashkëlidhur Aneksit B të këtij Protokollit.

## Neni 10

1. Ky Protokoll është pjesë integrale e Marrëveshjes për Krijimin e Forcës Multinacionale të Paqes së Europës Juglindore, nënshkruar në Shkup më 26 shtator 1998 dhe Protokollit të nënshkruar në Athinë më 12 janar 1999.

2. Ky Protokoll hyn në fuqi, kur të gjitha Palët vërtetojnë depozitimin e tij, pas kompletimit të të gjithë procedurave legale në Shtetet e tyre.

Nënshkruar në Bukuresht më 30 nëntor 1999 në 7 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Në emër të Palëve të Marrëveshjes:

Firma

Zoti Ilir BOÇKA, Zëvendësministër i Mbrojtjes

Firma

Zoti Gueorgui ANANIEV, Ministër i Mbrojtjes

Firma

Zoti Nikola KLUSJEV, Ministër i Mbrojtjes

Firma

Zoti Apostolos TSOHATZOPOULOS, Ministër i Mbrojtjes Kombëtare

Firma

Zoti Carlo SCOGNAMIGLIO, Ministër i Mbrojtjes

Firma

Zoti Victor BABUIC, Ministër i Mbrojtjes Kombëtare

Firma

Zoti Sabahattin Cakmakoglu, Ministër i Mbrojtjes

## ANEKSI A KONTRIBUTET KOMBËTARE

Kombi Nr. 1: Një kompani xheniere

Kombi Nr. 2: Një kompani xheniere

Kombi Nr. 3: Një kompani xheniere

Kombi Nr. 4: Një shtabin e Regjimentit Xhenier (me një kompani të këtij regjimenti).

Kombi Nr. 5: Një togë xheniere

Kombi Nr. 6: Një kompani xheniere

Kombi Nr. 7: Një kompani xhenio-ndërtuese

**L I G J**  
**Nr.8641, datë 13.7.2000**

**PËR RATIFIKIMIN E “PROTOKOLLIT VI TË “KONVENTËS EUROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Protokolli VI i “Konventës Europiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2703, datë 19.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**

**PROTOKOLLI VI**

Strasburg 28 prill 1983  
Hyrja në fuqi më 1 mars 1985

Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të këtij Protokollit të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, të nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1995, më tutje quajtur “Konventa”.

Duke marrë parasysh se zhvillimet e ndodhura në shumë Shtete Anëtare të Këshillit të Europës tregojnë një prirje të përgjithshme në favor të heqjes së dënimit me vdekje.

Janë marrë vesh për sa vijon:

Neni 1

**Heqja e dënimit me vdekje**

Dënimi me vdekje hiqet. Askush nuk mund të ndëshkohet me një dënim të tillë, as të ekzekutohet.

Neni 2

**Dënimi me vdekje në kohë lufte**

Një shtet mund të parashikojë në legjislacionin e tij dënimin me vdekje për veprime të kryera në kohë lufte ose rreziku shumë të afërt të luftës; një dënim i tillë do të zbatohet vetëm në rastet e parashikuara nga ky legjislacion dhe në përputhje me dispozitat që përfshin legjislacioni në fjalë.

Neni 3  
**Ndalimi i çdo shmangieje**

Asnjë shmangie nuk lejohet nga dispozitat e këtij Protokoll në bazë të nenit 57 të Konventës.

Neni 4  
**Ndalimi i rezervave**

Asnjë rezervë nuk pranohet në lidhje me dispozitat e këtij Protokoll në bazë të nenit 57 të Konventës.

Neni 5  
**Zbatimi territorial**

1. Çdo Shtet mundet, në çastin e nënshkrimit ose të dorëzimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit, të caktojë territorin ose territoret në të cilët do të zbatohet ky Protokoll.

2. Çdo Shtet mundet, në çdo çast të mëvonshëm, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, ta shtrijë zbatimin e këtij Protokoll në çdo territor tjetër të përcaktuar në deklaratë. Protokoll do të hyjë në fuqi në lidhje me këtë territor ditën e parë të muajit që do të pasojë datën e marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë në bazë të dy paragrafëve të mësipërme do të mund të tërhiqet, lidhur me çdo territor të caktuar në atë deklaratë, me një njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja do të bëhet e efektshme ditën e parë të muajit që pason datën e marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 6  
**Lidhjet me Konventën**

Shtetet Palë i konsiderojnë nenet 1 deri 5 të këtij Protokoll si nene shtojcë të Konventës dhe të gjitha dispozitat e Konventës do të zbatohen rrjedhimisht.

Neni 7  
**Nënshkrimi dhe ratifikimi**

Ky Protokoll është i hapur për nënshkrim nga ana e Shteteve anëtare të Këshillit të Europës nënshkruese të Konventës. Ai do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose mospranimit. Një Shtet, anëtar i Këshillit të Europës, nuk do të mund të ratifikojë, të pranojë ose të miratojë këtë Protokoll pa pasur ratifikuar njëkohësisht ose përparësisht Konventën. Instrumentet e ratifikimit, të pranimit ose të miratimit, do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 8  
**Hyrja në fuqi**

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason datën në të cilën pesë Shtete anëtare të Këshillit të Europës do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur me Protokollin sipas dispozitave të nenit 7.

2. Për çdo Shtet anëtar që do të shprehë më vonë pëlqimin e tij për t'u lidhur me Protokollin, ky do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason datën e depozitimit të instrumentit të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit.

Neni 9  
**Funksionet e depozituesit**

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i njoftojë Shtetet anëtare të Këshillit:

- a) për çdo nënshkrim;
- b) për dorëzimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi ose miratimi;
- c) për çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij Protokoll sipas neneve 5 dhe 8;
- d) për çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër lidhur me këtë Protokoll.

Duke u bazuar në sa më sipër, nënshkruarit rregullisht të autorizuar, e nënshkruan këtë Protokoll.

*Bërë në Strasburg më 28 prill 1983, në frëngjisht dhe në anglisht, duke qenë të dy tekstet të barasvlefshme, në një kopje të vetme që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës, do t'u dërgojë një kopje të vërtetuar, konform origjinalit, secilit prej Shteteve anëtare të Këshillit të Europës.*

**L I G J**  
**Nr.8642, datë 13.7.2000**

**PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS EUROPIANE  
“PËR SHTYPJEN E TERRORIZMIT””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Konventa Europiane “Për shtypjen e terrorizmit””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2704, datë 19.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani.**

**KONVENTA EUROPIANE PËR SHTYPJEN E TERRORIZMIT  
STRASBURG 27.1.1977**

Seria e traktateve europiane Nr. 90

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të kësaj Konvente,

Duke konsideruar se qëllimi i Këshillit të Europës është realizimi i një bashkimi më të ngushtë midis anëtarëve të tij;

Të ndërgjegjshëm për shqetësimin gjithnjë e në rritje të shkaktuar nga rritja e akteve të terrorizmit;

Duke dëshiruar marrjen e masave efektive që autorët e akteve të tilla të mos i shpëtojnë ndjekjes penale dhe ndëshkimit;

Të bindur se ekstradimi është një mjet i veçantë efikas për të arritur këtë rezultat,  
Kanë rënë dakord përsa vijon:

#### Neni 1

Për nevoja të ekstradimit midis shteteve kontraktuese, asnjë veprë penale që do të përmendet këtu më poshtë nuk do të konsiderohet si veprë penale politike, si veprë penale e lidhur me një veprë tjetër politike ose si veprë e frymëzuar nga qëllime politike:

a) veprat penale të përfshira në fushën e zbatimit të Konventës për shtypjen dhe marrjen e paligjshme të mjeteve fluturuese, të nënshkruar në Hagë më 16 dhjetor 1970;

b) veprat penale të përfshira në fushën e zbatimit të Konventës për shtypjen e akteve të paligjshme të drejtuara ndaj sigurisë së avionëve civilë, të nënshkruar në Montreal më 23 shtator 1971;

c) veprat e rënda penale që drejtohen kundër jetës, integritetit trupor ose lirisë së personave që gëzojnë të drejtën e mbrojtjes ndërkombëtare, duke përfshirë agjentët diplomatikë;

d) veprat penale që përmbajnë rrëmbim, marrje peng ose sekuestrim arbitrar personi;

e) veprat penale që përmbajnë përdorim bombash, granatash, raketash, armë zjarri automatike, ose letra apo pako shpërthyes në masën që ky përdorim paraqet rrezik për personat;

f) tentativa për kryerjen e një veprë penale të sipërpërmendur ose pjesëmarrja si bashkautor ose si bashkëpunëtor i një personi që kryen ose tenton të kryejë një veprë penale të tillë.

#### Neni 2

1. Për nevoja të ekstradimit midis Shteteve kontraktuese, Shteti kontraktues nuk mund të konsiderojë si veprë penale politike, si veprë penale e lidhur me një veprë të tillë penale ose si veprë penale e frymëzuar nga qëllime politike, çdo akt të rëndë të dhunës që nuk është parashikuar nga neni 1 dhe që drejtohet kundër jetës, integritetit trupor ose lirisë së personave.

2. Do të konsiderohet njëllor lidhur me çdo akt të rëndë kundër pasurisë, veç atyre të parashikuara nga neni 1, kur ai ka krijuar një rrezik kolektiv të personave.

3. Do të konsiderohet njëllor lidhur me tentativën për kryerjen e njëjës nga veprat penale të lartpërmendura ose pjesëmarrja si bashkautor ose bashkëpunëtor i një personi që kryen ose tenton të kryejë një veprë penale të tillë.

#### Neni 3

Dispozitat e të gjithë traktateve dhe marrëveshjeve të ekstradimit të zbatueshme midis Shteteve kontraktuese, duke përfshirë këtu Konventën Europiane për Ekstradimin, lidhur me marrëdhëniet midis Shteteve kontraktuese, modifikohen në masën që ato janë të pajtueshme me këtë Konventë.

#### Neni 4

Për nevoja të kësaj Konvente dhe kur njëra nga veprat penale të parashikuara nga nenet 1 e 2 nuk figuron në listën e rasteve të ekstradimit në një traktat ose konventë ekstradimi në fuqi midis Shteteve kontraktues, ajo do të konsiderohet si të ishte e përfshirë në atë listë.

#### Neni 5

Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk duhet interpretuar se passjell një detyrim për

ekstradim nëse Shteti i kërkuar ka arsye serioze të besojë se kërkesa e ekstradimit, e motivuar për një veprë penale të parashikuar në nenet 1 e 2, është paraqitur me qëllim të ndjekjes ose të dënimit të një personi për shkaqe të racës, fesë, kombësisë ose opinioneve politike, ose kur gjendja e këtij personi rrezikon të rëndohet për njerën nga këto arsye.

#### Neni 6

1. Çdo Shtet kontraktues merr masa të nevojshme për të përcaktuar kompetencën e vet me qëllim të njohjes të një veprë penale të parashikuar nga neni 1 në rastin kur autori i dyshuar për veprën penale ndodhet në territorin e tij dhe kur Shteti nuk e ekstradon atë pasi ka marrë një kërkesë ekstradimi nga një Shtet kontraktues, kompetenca e të cilit për ndjekje penale bazohet në një rregull kompetence që ekziston edhe në legjislacionin e Shtetit të kërkuar.

2. Kjo Konventë nuk përjashton asnjë kompetencë penale të ushtruar konform ligjeve kombëtare.

#### Neni 7

Një Shtet kontraktues, në territorin e të cilit është zbuluar autori i dyshuar i një veprë penale të parashikuar nga neni 1, dhe që ka marrë një kërkesë ekstradimi në kushtet e përmendura në paragrafin 1 të nenit 6, nëse nuk ekstradon autorin e dyshuar të veprës penale, ia paraqet çështjen, pa asnjë përjashtim e pa asnjë vonesë të pajustificuar, autoriteteve të veta kompetente për ushtrimin e ndjekjes penale. Këto autoritete marrin vendimin e tyre në të njëjtat kushte, si dhe për çdo veprë penale me karakter të rëndë konform ligjeve të këtij Shteti.

#### Neni 8

1. Shtetet kontraktuese u japin njëra-tjetrës, sa më shumë që të jetë e mundur, ndihmën gjyqësore në fushën penale në çdo procedurë lidhur me veprat penale të parashikuara nga neni 1 ose 2. Në të gjitha rastet, ligji i zbatueshëm lidhur me ndihmën e ndërsjelltë në fushën penale është ai i Shtetit të kërkuar. Megjithatë, ndihma gjyqësore nuk mund të refuzohet me motivin e vetëm që ajo ka të bëjë me një veprë penale politike ose një veprë penale të lidhur me një veprë penale të tillë ose një veprë penale të frymëzuar nga qëllime politike.

2. Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk duhet interpretuar se ajo passjell detyrimin për të dhënë ndihmën gjyqësore nëse Shteti i kërkuar ka arsye serioze për të besuar se kërkesa për ndihmë, e motivuar për një veprë penale të parashikuar nga neni 1 ose 2, është paraqitur me qëllim të ndjekjes ose të dënimit të një personi për shkak të racës, fesë, kombësisë ose opinioneve politike, ose që gjendja e këtij personi rrezikon të rëndohet për njerën nga këto arsye.

3. Dispozitat e të gjitha traktateve e marrëveshjeve për ndihmë të ndërsjelltë gjyqësore në fushën penale të zbatueshme midis Shteteve kontraktuese, duke përfshirë Konventën Europiane për Ndihmën e Ndërsjelltë Gjyqësore në fushën penale, modifikohen, sa i takon marrëdhëniet midis Shteteve kontraktuese, në masën që ato pajtohen me këtë Konventë.

#### Neni 9

1. Komiteti European për problemet penale të Këshillit të Europës ndjek ekzekutimin e kësaj Konvente.

2. Ai lehtëson me aq sa nevojitet një rregullim me pajtim të çdo vështirësie që do të lindë në ekzekutim të Konventës.

#### Neni 10

1. Çdo mosmarrëveshje midis Sheteve kontraktuese lidhur me interpretimin e kësaj Konvente që nuk është rregulluar në kuadër të paragrafit 2 të nenit 9, me kërkesë të njerës nga Palët

në konflikt, do t'i nënshtrohet arbitrazhit. Secila nga Palët do të caktojë një arbitër dhe të dy arbitrat do të caktojnë një arbitër të tretë. Nëse, brenda një afati tremujor duke filluar nga kërkesa e arbitrazhit, njëra nga Palët nuk ka vepruar për caktimin e një arbitri, arbitri do të caktohet me kërkesë të Palës tjetër, nga Kryetari i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Nëse Kryetari i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut është shtetas i njëres prej Palëve në konflikt, caktimi i arbitrit do të bëhet nga Nënkryetari i Gjykatës, nëse Nënkryetari është shtetas i njëres nga Palët në konflikt, anëtari i Gjykatës me vjetërsi më të madhe që nuk është shtetas i njëres nga Palët në konflikt. E njëjta procedurë do të zbatohet në rast se të dy arbitrat nuk bien dakord për zgjedhjen e arbitrit të tretë.

2. Gjykata e arbitrazhit do ta marrë me vendim procedurën e vet. Vendimet e saj do të merren me shumicë votash. Vendimi do të jetë përfundimtar.

#### Neni 11

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim për Shtetet anëtare të Këshillit të Europës. Ajo ratifikohet, pranohet ose miratohet. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, ose miratimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Konventa do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës kur bëhen tre depozitime të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

3. Ajo do të hyjë në fuqi ndaj çdo Shteti që do ta ratifikojë, pranojë ose miratojë i fundit, tre muaj pas datës së depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

#### Neni 12

1. Çdo Shtet mundet, në çastin e nënshkrimit ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose miratimit, të caktojë territorin ose territoret ku do të zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo Shtet mundet, në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose miratimit ose në çdo moment tjetër më pas, të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, në çdo territor tjetër të caktuar në deklaratë dhe në të cilin ai realizon marrëdhëniet ndërkombëtare ose për të cilin ai është i autorizuar t'i realizojë.

3. Çdo deklaratë bërë në bazë të paragrafit të mëparshëm mund të tërhiqet, lidhur me çdo territor të caktuar në këtë deklaratë, me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja do të ushtrojë efektet menjëherë ose në një datë të mëvonshme të përcaktuar në njoftim.

#### Neni 13

1. Çdo Shtet mundet, në çastin e nënshkrimit ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose miratimit, të deklarojë që ai rezervon të drejtën të refuzojë ekstradimin lidhur me çdo vepër penale të renditur në nenin 1 që ai e konsideron si vepër penale politike ose vepër penale e frymëzuar nga qëllime politike, me kusht që ai të angazhohet të marrë në konsideratë në mënyrë të duhur, gjatë cilësimit të karakterit të veprës penale, karakterin e rëndësisë së veçantë, duke përfshirë:

a) që ajo ka krijuar një rrezik kolektiv për jetën, integritetin trupor, ose lirinë e personave; ose

b) që ajo ka prekur persona të huaj për nga qëllimet që është frymëzuar; ose

c) që mjete mizore ose të rrezikshme janë përdorur për realizimin e saj.

2. Çdo Shtet mund të tërheqë tërësisht ose pjesërisht rezervën e formuluar prej tij në bazë të paragrafit të mëparshëm me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe që do të fillojë efektet e veta nga data e marrjes së saj.

3. Shteti që ka formuluar një rezervë në bazë të paragrafit 1 të këtij neni nuk mund të pretendojë për zbatimin e nenit 1 nga çdo Shtet tjetër; megjithatë, ai mundet, nëse rezerva është e

pjesshme ose me kusht, të pretendojë për zbatimin e këtij neni në masën që ai vetë e ka pranuar.

#### Neni 14

Çdo Shtet kontraktues mund të denoncojë këtë Konventë duke i drejtuar një njoftim me shkrim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Një denoncim i tillë do të ushtrojë efektet menjëherë ose në një datë të mëvonshme të përcaktuar në njoftim.

#### Neni 15

Konventa pushon së prodhuari efektet e veta ndaj çdo Shteti kontraktues që tërhiqet nga Këshilli i Europës ose pushon së qeni anëtar i këtij.

#### Neni 16

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u njoftojë Shteteve anëtare të Këshillit:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitimi i instrumenteve të ratifikimit, të pranimi ose të miratimit;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente konform nenit 11;
- d) çdo deklaratë ose njoftim të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 12;
- e) çdo rezervë të formuluar bërë në zbatim të paragrafit 1 të nenit 13;
- f) tërheqja e çdo rezerve të bërë në zbatim të paragrafit 2 të nenit 13;
- g) çdo njoftim të marrë në zbatim të nenit 14 dhe datën në të cilën denoncimi do të marrë efektet e veta;
- h) çdo pushim të efekteve të Konventës në zbatim të nenit 15.

Me këtë mirëbesim, nënshkruarit, të autorizuar rregullisht për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Konventë.

*Bërë në Strasburg, më 27 janar 1977, në frëngjisht dhe anglisht, të dy tekstet janë njëllloj të besueshëm, në një ekzemplar të vetëm që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u komunikojë nga një kopje të vërtetuar konform secilit nga Shtetet anëtare nënshkruar.*

### V E N D I M

**Nr.446, datë 13.7.2000**

### **PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR LIRIMIN E ZOTIT ARBEN DEMETI NGA DETYRA E MINISTRIT TË PUNËVE PUBLIKE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 pika 2 të Kushtetutës,

### **K U V E N D I**

#### **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:**

I. Miratohet dekreti nr.2680, datë 7.7.2000 i Presidentit të Republikës për lirimin e zotit Arben Demeti nga detyra e Ministrit të Punëve Publike.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**V E N D I M**  
**Nr.447, datë 13.7.2000**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR LIRIMIN E ZOTIT ILIR ZELA NGA DETYRA E MINISTRIT TË SHETIT PRANË KRYEMINISTRIT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 pika 2 të Kushtetutës,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

I. Miratohet dekreti nr.2681, datë 7.7.2000 i Presidentit të Republikës për lirimin e zotit Ilir Zela nga detyra e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**V E N D I M**  
**Nr.448, datë 13.7.2000**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR LIRIMIN E ZOTIT ILIR PANDA NGA DETYRA E MINISTRIT TË DREJTËSISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 pika 2 të Kushtetutës,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

I. Miratohet dekreti nr.2682, datë 7.7.2000 i Presidentit të Republikës për lirimin e zotit Ilir Panda nga detyra e Ministrit të Drejtësisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**V E N D I M**  
**Nr.449, datë 13.7.2000**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR LIRIMIN E ZOTIT LUAN HAJDARAGA NGA DETYRA E MINISTRIT TË MBROJTJES**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 pika 2 të Kushtetutës,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

I. Miratohet dekreti nr.2683, datë 7.7.2000 i Presidentit të Republikës për lirimin e zotit Luan Hajdaraga nga detyra e Ministrit të Mbrojtjes.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**V E N D I M**

**Nr.450, datë 13.7.2000**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E ZOTIT ILIR GJONI MINISTËR I MBROJTJES**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 pika 2 të Kushtetutës,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

I. Miratohet dekreti nr.2684, datë 7.7.2000 i Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Ilir Gjoni në detyrën e Ministrit të Mbrojtjes.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**V E N D I M**

**Nr.451, datë 13.7.2000**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E ZOTIT ILIR ZELA MINISTËR TË PUNËVE PUBLIKE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 pika 2 të Kushtetutës,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

I. Miratohet dekreti nr.2685, datë 7.7.2000 i Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Ilir Zela në detyrën e Ministrit të Punëve Publike.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**V E N D I M**  
**Nr.452, datë 13.7.2000**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E  
ZOTIT ARBEN IMAMI MINISTËR TË DREJTËSISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 pika 2 të Kushtetutës,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

- I. Miratohet dekreti nr.2686, datë 7.7.2000 i Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Arben Imami në detyrën e Ministrit të Drejtësisë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**V E N D I M**  
**Nr.453, datë 13.7.2000**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E  
ZOTIT NDRË LEGISI MINISTËR SHTETI PRANË KRYEMINISTRIT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 pika 2 të Kushtetutës,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

- I. Miratohet dekreti nr.2687, datë 7.7.2000 i Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Ndre Legisi në detyrën e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**D E K R E T**  
**Nr. 2699, datë 19.07.2000**

**PËR LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 05.08.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

**D E K R E T O J**

Neni 1

U hiqet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ilir Hamit Idrizi
2. Ilir Xhavit Sheganaku
3. Mimoza Muhamet Sheganaku (Erebara)
4. Mimoza Gani Currenti (Luku)
5. Shkëlqim Xhevdet Cama
6. Mereme Shkëlqim Cama
7. Franziska Shkëlqim Cama
8. Stela Shkëlqim Cama
9. Tefta Sefer Cama (Hima)
10. Mehmet Qazim Kraja
11. Gëzim Bajram Bareti
12. Shpëtim Hasan Haxhi
13. Igli Muharrem Ferhati
14. Edis Muharrem Ferhati
15. Alba Llesh Bardhi (Rica)
16. Kelvin Agim Bardhi
17. Samantha Agim Bardhi
18. Artur Eqerem Beliu
19. Gerti Artur Beliu
20. Sendi Artur Beliu
21. Greta Ahmet Beliu (Pazari)
22. Artur Vangjel Lulo
23. Nikoleta Uani Laçka (Gjergji)
24. Jona Piro Laçka
25. Jonuz (Yonuz) Mersin Mema
26. Marsida Jonuz Mema
27. Luljeta Gani Mema (Bajrami)
28. Enkel Adnan Halili
29. Sara Enkel Halili
30. Kevin Enkel Halili

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Rexhep Meidani**

**V E N D I M**  
**Nr.353, datë 7.7.2000**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
NR.190, DATË 3.5.1995, “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7874, DATË 17.11.1994 “PËR  
STATUSIN E VETERANIT TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË  
POPULLIT SHQIPTAR”**

Në mbështetje të nenit 100, pika 2 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 14, të ligjit nr.7894, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, ndryshuar me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

## V E N D O S I:

Në vendimin nr.190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 shtohet paragrafi si vijon:

“Në Ministrinë e Mbrojtjes krijohet kartoteka e departamentit të veteranëve dhe të invalidëve të Luftës, e cila administron dosjet e veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare deri në përfundimin e punës së Komisionit Qendror të Statusit të Veteranit të Luftës Nacionalçlirimtare dhe dorëzimit në Arkivin Qendror të Ushtrisë.”.

2. Në pikën 5 shtohet paragrafi si vijon:

“Dokument zyrtar, me burim arkivor të referuar qartë, vlerësohet dokumenti i dalë nga arkivat e institucioneve zyrtare, ku janë shënuar qartë, referencat e regjistrimit të tij: institucioni që e lëshon, numri i fondit, numri i dosjes, numri i fletës, viti i dokumentit dhe lloji i tij.”.

3. Në pikën 8 shtohet paragrafi si vijon:

“Ky shpërblim u jepet shtesë veteranëve të tjerë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ish-të burgosur politikë, antifashistë, brenda dhe jashtë vendit.”.

4. Në pikën 10 shtohet paragrafi si vijon:

“Për raste të veçanta, kur ka mungesa objektive për vërtetimin e internimit jashtë vendit në kampet e përqëndrimit nazifashist, Komisioni Qendror i Statusit të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare mund të vendosë, në bazë të dokumenteve të arkivave zyrtare, shqiptare. Në çdo rast përmbajtja e dokumentit duhet të verifikohet.”.

5. Pika 11 ndryshon si vijon:

“a) Veteranët e plagosur në luftë, që nuk përfitojnë statusin e invalidit të luftës, përveç shpërblimit mujor të veteranit marrin edhe një shtesë, në masën 945 (nëntëqindëzetepesë) lekë në muaj.

b) Komisioni i Spitalit Qendror të Ushtrisë vërteton nëse ka plagosje me armë zjarri. Vizita bëhet me paraqitjen e librezës së Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ose të dokumentit të lëshuar nga Departamenti i Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës, pranë Ministrisë së Mbrojtjes ose të komisionit të statusit të veteranit të luftës të rrethit, ku personi ka paraqitur kërkesën dhe dokumentet.

c) Deklarata e bashkëluftëtarit për rrethanat e plagosjes në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare përmban identitetin e plotë të veteranit, numrin e regjistrimit themeltar të librezës së tij, pjesëmarrjen e tij të drejtpërdrejtë në luftimin ku është plagosur bashkëluftëtari, kohën dhe vendin e saktë ku dhe kur ka ndodhur.

ç) Komisioni Qendror i Statusit të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe Departamenti i Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës, kur e shikojnë të nevojshme, bëjnë vërtetimin e deklaratës”.

6. Pika 17 ndryshon si vijon:

“Shpërblimi i veteranit të luftës jepet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, kundrejt paraqitjes së librezës së Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, të lëshuar nga Komisioni Qendror, pranë Ministrisë së Mbrojtjes.”.

7. Pas pikës 20 shtohen pika 21 dhe 22, me këtë përmbajtje:

“21. Në zbatim të nenit 5, të ligjit nr.8526, datë 23.9.1999, Departamenti i Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës, në Ministrinë e Mbrojtjes, paraqet listat e kërkuesve për “statusin e veteranit”, të ardhura nga komisionet e rretheve në zyrën e gjendjes gjyqësore, pranë Ministrisë së Drejtësisë.

- Pas paraqitjes së dëshmisë së penaltetit dosja përkatëse e personit rishihet nga Komisioni Qendror i Statusit të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, i cili merr vendimin përkatës.

- Departamenti i Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës të paraqesë, në zyrën e gjendjes gjyqësore, kërkesat për dëshmi penalteti për veteranët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, të cilëve u është njohur deri tani statusi. Kjo zyrë, deri më 31 gusht 2001, të lëshojë për to dëshmi penalteti.

Dosja e veteranit, për të cilin, sipas dëshmisë së penalitetit, rezulton se është dënuar për krime lufte, për bashkëpunim me pushtuesit nazifashistë ose për veprimtari agjenturore kundër interesave të atdheut, me vendim gjykate të formës së prerë, rishqyrtohet nga Komisioni Qendror i Statusit të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, i cili merr edhe vendimin përkatës.”.

“22. Për financimin e organizatave të veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, Ministria e Financave paraqet çdo vit, në buxhetin e shtetit, fondin përkatës.

Ndarja e fondit për organizatat e veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare bëhet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, në përputhje me numrin e veteranëve që e kanë përfituar statusin e veteranit, e që janë anëtarë të këtyre organizatave, për çdo rreth, me listat emërore përkatëse të veteranëve që jetojnë dhe me numrin e regjistrimit themeltar të librezës së tyre.”.

8. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministrisë e Transportit të nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

9. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të pajisë, brenda muajit shkurt të vitit 2001, me librezën e re të veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të gjithë veteranët që jetojnë, në bazë të librezës që dorëzohet dhe të çertifikatës së gjendjes civile. Libreza e mëparshme del jashtë përdorimit.

10. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 1.12.1994, datë e hyrjes në fuqi të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, me përjashtim të shpërblimit në pikën 3, që fillojnë nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8526, datë 23.9.1999, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste të popullit shqiptar”.

11. Efektet financiare, në zbatim të pikave 3.4 dhe 5 të këtij vendimi, përballohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me fondin e dhënë në buxhetin e vitit 2000, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**V E N D I M**  
**Nr.354, datë 7.7.2000**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMN NR.217, DATË 5.5.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KONTROLLIN FINANCIAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në vendimin nr.217, datë 5.5.2000, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 3.4, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Drejtori i drejtorisë së kontrollit në prefekturë emërohet nga ministri i Pushtetit Lokal, me propozimin e prefektit.”.

2. Pika 3.5 ndryshohet si vijon:

Në vendimin nr.393, datë 3.9.1992, të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimin nr.213, datë 28.3.1998 bëhen këto shtesa:

“Në Lidhjen “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit”, në shkronjën B1 shtohet emërtimi “Drejtor departamenti në minisri”.

Në shkronjën B3 shtohet emërtimi “Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit, në ministri”.

Në shkronjën B4 shtohet emërtimi “Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit, në prefekturë, përgjegjës sektori dhe përgjegjës i zyrës së kontrollit, në ministri”.

Në shkronjën B5 shtohet emërtimi “Inspektor i kontrollit në ministri”.

Në shkronjën C2 shtohet emërtimi “Inspektor kontrolli në drejtoritë e kontrollit, në prefektura”.

3. Në pikën 2.1.3, shprehja “Me urdhër të qeverisë“, zëvendësohet “Me urdhër të Kryeministrit”.

4. Pika 2.2.5 ndryshohet si vijon:

“Drejtoritë e kontrollit financiar në prefektura, sipas ligjit, kanë detyrë të mbulojnë, brenda vitit, me kontroll-revizioni të përgjithshëm të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, për fondet e dhëna nga buxheti i shtetit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**V E N D I M**  
**Nr.361, datë 14.7.2000**

**PËR SHPËRNDARJEN ME KOEFICIENT PJESORË TË VLERAVE FINANCIARE,  
KREDITORËVE TË SHOQËRISË “SILVA”, SH.P.K., NË ADMINISTRIM, ME TË  
ARDHURAT E REALIZUARA NGA SHITJA E ASETETEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, dhe të neneve 3, 4 e 8 pika 3, të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998, “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë“, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Fillimin e kompensimit të pjesshëm të kreditorëve të shoqërisë “Silva”, sh.p.k., në administrim, me të ardhurat e realizuara nga shitja e asetëve në ankandet e shitjes publike me tender.

2. Shuma e detyrimit të mbetur që shoqëria “Silva”, sh.p.k., në administrim, ka ndaj kreditorëve është 3 232 496 204 lekë.

- Të ardhurat financiare të realizuara nga shitja e asetëve të shoqërisë “Silva” sh.p.k., në administrim, depozituar në bankë, së bashku me ato gjendje, kapin vlerën 640 milionë lekë.

- Koeficienti pjestor i kthimit të vlerave financiare kreditorëve është 20,15 për qind.

3. Ngarkohet Banka e Kursimeve me degët e saj në rrethet Vlorë e Tiranë, për shpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Silva”, sh.p.k., në administrim.

- Shpenzimet për shpërblimet, që do të kryhen në sportelet e Bankës së Kursimeve për kompensimin e vlerave financiare kreditorëve, përballohen nga zëri “shpenzime” i buxhetit të vitit 2000, i miratuar për Grupin e Mbikëqyrjes.

4. Administratorët e përbashkët të shoqërisë “Silva” sh.p.k., në administrim, të bashkërendojnë punën me Zyrat e Përmbartimit Gjyqësor, për arkëtimin e vlerave financiare nga personat fizikë e juridikë të shpallur debitorë, dhe nga personat që kanë përfituar vlerat financiare nga transaksionet e pronësisë, për realizimin, në një periudhë të dytë, të një rikompensimi tjetër.

5. Dokumentacioni financiar i veprimtarisë së huamarrjes së shoqërisë “Silva” sh.p.k., në

administrim, t'i dorëzohen organit të prokurorisë, i cili në zbatim të Kodit të Procedurës Civile, të kërkojë në procesin gjyqësor ndaj ish administratorit, detyrim për kthim të shumave të pashlyera, sipas kontratave të kreditorëve.

6. Ngarkohen Banka e Kursimeve, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Grupi i Mbikëqyrjes dhe administratorët e përbashkët të shoqërisë “Silva”, sh.p.k., në administrim, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**V E N D I M**  
**Nr. 362, datë 14.7.2000**

**PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE, TË VLERAVE MESATARE TË TREGUT TË LIRË TË BANESAVE DHE TË KOEFICIENTIT “K”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3,7,8 e 13, të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Në shkallë Republike, për vitin 2000, kostoja mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të jetë 29 201 (njëzetënëntë mijë e dyqindnjë) lekë/m<sup>2</sup> sipërfaqe shfrytëzimi.

2. Vlerat mesatare të apartamenteve tip të tregut të lirë të banesave, në shkallë rrethi, për vitin 2000 të jenë sipas tabelës “ Të dhënat për tregun e lirë të apartamenteve, për vitin 2000”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Vlera e koeficientit “k”, e nenit 3, të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, të jetë sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**VLEFTA E KOEFICIENTIT “K” SIPAS LIGJIT NR.8030 DT. 15/11/ 1//5  
“PËR KONTRIBUTIN E SHTETIT PËR FAMILJET E PASTREHA”**

<b>Nr.</b>	<b>QYTETET</b>	<b>Vlefte e Koeficientit “K”</b>
1.	Berat	1,00
2.	Bulqizë	0,38

3.	Cërrik	0,91
4.	Delvinë	0,62
5.	Devoll	0,91
6.	Dibër	0,71
7.	Durrës	1,00
8.	Elbasan	1,00
9.	Fier	1,00
10.	Fush-Arëz	0,33
11.	Gjirokastrë	1,00
12.	Gramsh	1,00
13.	Has	0,55
14.	Kavajë	1,00
15.	Kolonjë	0,49
16.	Korçë	1,00
17.	Krujë	0,91
18.	Kuçovë	0,86
19.	Kukës	0,68
20.	Laç	0,92
21.	Leskovik	0,46
22.	Lezhë	1,00
23.	Librazhd	1,00
24.	Lushnjë	0,98
25.	M. Madhe	0,87
26.	Maliq	0,53
27.	Mallakastër	1,00
28.	Mat	0,62
29.	Memaliaj	0,41
30.	Mirditë	0,87
31.	Patos	0,90
32.	Peqin	1,00
33.	Përmet	0,96
34.	Pogradec	1,00
35.	Pukë	0,48
36.	Roskovec	0,81
37.	Rubik	0,70
38.	Sarandë	1,00
39.	Shkodër	1,00
40.	Skrapar	0,50
41.	Tepelenë	0,66
42.	Tiranë	1,00
43.	Tropojë	0,46
44.	Vau-Dejë	0,66
45.	Vlorë	1,00

<b>Nr.</b>	<b>QYTETET</b>	<b>Mijë lek/m2 sipërfaqe shfrytëzimi</b>
1.	Berat	31,29
2.	Bulqizë	10,89
3.	Cërrik	23,63
4.	Delvinë	15,68
5.	Devoll	23,05
6.	Dibër	20,48
7.	Durrës	55,11
8.	Elbasan	44,79
9.	Fier	43,05
10.	Fush-Arrëz	12,23
11.	Gjirokastrë	40,42
12.	Gramsh	40,10
13.	Has	25,79
14.	Kavajë	43,86
15.	Kolonjë	12,64
16.	Korçë	33,60
17.	Krujë	23,59
18.	Kuçovë	20,12
19.	Kukës	31,70
20.	Laç	23,59
21.	Leskovik	11,85
22.	Lezhë	50,63
23.	Librazhd	44,81
24.	Lushnjë	26,89
25.	M. Madhe	22,60
26.	Maliq	13,67
27.	Mallakastër	38,43
28.	Mat	15,66
29.	Memaliaj	10,50
30.	Mirditë	24,62
31.	Patos	23,81
32.	Peqin	41,28
33.	Përmet	24,89
34.	Pogradec	35,46
35.	Pukë	17,82
36.	Roskovec	21,40
37.	Rubik	19,86
38.	Sarandë	48,48
39.	Shkodër	36,91
40.	Skrapar	13,14
41.	Tepelenë	16,90
42.	Tiranë	53,40
43.	Tropojë	21,48
44.	Vau-Dejë	20,52
45.	Vlorë	50,41

KOSTO MESATARE E PONDERUAR

Nr	QYTETI	KOSTO L/M2		% E INVESTUAR	PJESË E ÇMIMIT SIPAS %	
		PËR SIP. NDËRTIMI	PËR SIP. SHFRYTËZIM		PËR SIP. NDËRTIMI	PËR SIP. SHFRYTËZIM
1	TIRANË	24780	28177	20.51	5082	5779
2	DURRËS	23501	27565	9.22	2167	2541
3	KORÇË	21266	26266	3.4	723	893
4	SHKODËR	25825	32433	16.51	4263	5255
5	VLORË	28158	35506	5.46	1537	1939
6	ELBASAN	19012	24264	9.2	1749	2232
7	KAVAJË	21743	26855	2.4	522	645
8	FIER	21202	26602	3.72	789	990
9	LEZHË	23041	30051	2.19	505	658
10	PUKË	31261	38565	1	313	386
11	KUKËS	39024	48428	1.24	484	601
12	TROPOJË	38979	48086	0.71	277	341
13	GJIROKASTËR	31106	40465	0.86	266	348
14	BERAT	21225	26228	2.57	546	674
15	LUSHNJË	22303	28497	2.9	647	826
16	BURREL	21673	26310	2.46	533	647
17	RRËSHEN	24426	29653	0.24	59	71
18	TEPELENË	21812	26480	1.85	404	490
19	PËRMET	21828	26974	0.33	72	89
20	DIBËR	23108	30047	2.78	642	835
21	KRUJË	21132	24627	1.88	397	463
22	LIBRAZHD	20792	29164	0.46	96	134
23	PEQIN	19943	25453	0.26	52	66
24	GRAMSH	20885	26655	0.68	142	181
25	POGRADEC	26117	28976	0.77	201	223
26	SARANDE	30887	40151	1.48	457	594
27	LAÇ	21811	26478	2.24	489	593
28	KUÇOVË	19675	24213	0.7	138	169
29	SKRAPAR	21599	277435	1.96	423	538
	SHUMA				23975	29201

**V E N D I M**

**Nr.364, datë 14.7.2000**

**PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE, QË SHKURTOHEN NGA ZBATIMI I MARRËVESHJES SË KONCESIONIT, PËR UZINËN E FERROKROMIT, ELBASAN DHE PËR MINIERAT E KROMIT PËRRENJAS DHE POJSKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8562, datë 22.12.1999, “Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive anonime “Albkrom””

dhe të ligjit nr.8590, datë 23.3.2000, “Për miratimin e marrëveshjes së koncensionit, të formës “BOT”, për Uzinën e Ferrokromit, Elbasan, dhe për minierat e kromit Përrenjas e Pojskë, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë italiane DARFO, s.p.a., për dhënien e disa stimuljeve dhe garancive për koncensionarin e kësaj marrëveshjeje”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

#### V E N D O S I:

1. Punonjësve që dalin të tepërt, si pasojë e zbatimit të marrëveshjes së koncensionit, për Uzinën e Ferrokromit, Elbasan dhe për minierat e kromit Përrenjas dhe Pojskë, t’u jepet një shpërblim i barabartë me pagën e 2 (dy) viteve. Si pagë do të merret paga mujore bazë dhe vjetërsia në punë, që kanë patur në çastin e shkëputjes nga puna.

2. Fondet financiare prej 129 milionë lekësh, të nevojshme për dhënien e shpërblimit 398 punonjësve të Uzinës së Ferrokromit, Elbasan dhe të minierave të kromit Përrenjas dhe Pojskë, që do të trajtohen sipas këtij vendimi, të përballohen nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, nga fondet e dhëna prej koncensionarit dhe nga ato të krijuarat në zbatim të vendimit nr.416, datë 9.7.1998, të Këshillit të Ministrave.

3. Përfitojnë nga ky vendim ata punonjës të Uzinës së Ferrokromit, Elbasan dhe të minierave të kromit Përrenjas dhe Pojskë, të cilët kanë qenë të punësuar pranë këtyre njësive, pandërprerje, që nga 1.6.1999, e deri në periudhën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Shpërblimi i punonjësve që dalin të tepërt nga zbatimi i marrëveshjes së koncensionit për Uzinën e Ferrokromit, Elbasan dhe për minierat e kromit Përrenjas dhe Pojskë, do të bëhet nga sh.a., “Albkrom”, me 4 (katër) këste, të barabarta, në çdo 6 muaj. Kësti i parë do të jepet në muajin korrik 2000.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

#### V E N D I M Nr.365, datë 14.7.2000

#### **PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE QË SHKURTOHEN NGA RISTRUKTURIMI I INDUSTRIË SË BAKRIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr 8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

#### V E N D O S I:

1. Nuk vlerësohen sektorë me rëndësi të veçantë dhe t’u nënshtrohen procesit të privatizimit, mbylljes dhe likuidimit, duke filluar nga 1.7.2000, sektorët e poshtëshënuar të industrisë së bakrit.

Miniera e bakrit, Krumë	Has
Miniera e bakrit, Nikoliq 1	Has
Fabrika e pasurimit të bakrit, Golaj	Has
Miniera e bakrit, Qafë-Bari	Pukë

Miniera e bakrit , Fushë –Arrëz	Pukë
Parku i transportit Fushë-Arrëz	Pukë
Miniera e bakrit , Spaç	Mirditë
Miniera e bakrit, Gurth, Spaç 1	Mirditë
Fabrika nr.1.e pasurimit të bakrit, Reps	Mirditë
Parku i transportit, Rrëshen	Mirditë
Uzina e bakrit, Laç	Kurbini
Miniera e bakrit, Rehovë	Korçë
Fabrika e pasurimit të bakrit, Rehovë	Korçë
Impianti i boksideve	Korçë
Objektet e sh.a NNM Metalifere	Tiranë

2. Për ruajtjen deri në privatizimin dhe likuidimin e plotë të asetëve të objekteve të mësipërme duhen 115 punonjës dhe 34 policë privatë, si dhe një fond pagë mujore prej 2 444 milionë lekësh në muaj, nga të cilat 16.15 milionë lekë për vitin 2000, përfshirë fondet për energji etj, fonde të cilat do të paguhen nga buxheti i shtetit.

3. Sektorët e industrisë së bakrit, të cilët në rast investimi rezultojnë të frytshëm e me perspektivë dhe që do të mbahen në regjim të përkohshëm konservimi janë:

Miniera e bakrit, Lak Rroshi	Pukë
Miniera e bakrit, Munellë	Pukë
Fabrika e pasurimit të bakrit, Fushë-Arrëz	Pukë
Miniera e bakrit, Karmë 2	Shkodër
Fabrika e pasurimit të bakrit, Mjedë	Shkodër
Miniera e bakrit, Perlati jugor	Mirditë
Fabrika e pasurimit të bakrit, Rrëshen	Mirditë
Uzina e bakrit, Rubik	Mirditë
Impianti i skorjeve, Shëngjin	Lezhë

4. Fondet e nevojshme për ruajtjen dhe konservimin e sektorëve të industrisë së bakrit, të cilët do të mbahen në regjim të përkohshëm konservimi, arrijnë vlerat e 2.88 milionë lekëve në muaj, prej të cilave 18.8 milionë lekë nevojiten për të mbyllur vitin 2000, përfshirë fonde për energji etj, fonde të cilat do të përballohen nga buxheti i shtetit.

5. Punonjësit që dalin të tepërt, si pasojë e privatizimit apo likuidimit të sektorëve të industrisë së bakrit, por që deri më datën 1.6.2000 kanë qenë në marrëdhënie pune dhe që do të jenë të tillë deri në çastin e mbylljes së objekteve, të cituara në pikën 1 të këtij vendimi, të trajtohen për 1(një) vit me pagën minimale në shkallë vendi në çastin e hyrjes në fuqi të vendimit në fjalë.

6. Periudha 1(një) vjeçare e përmendur në pikën 5 të vendimit të njihet si vjetërsi pune, për efekt pensioni, dhe të shënohet e tillë në librezë.

7. Përfitojnë nga ky vendim ata punonjës të “industrisë së bakrit”, të cilët kanë qenë të punësuar pranë kësaj shoqërie pandërprerje, që nga data 1.6.1999 e deri në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi e kanë ata punonjës që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike, në formën e punësimit apo të vetëpunësimit. Në rast të kundërt u ndërpritet trajtimi që përfitojnë sipas këtij vendimi. Po kështu, trajtimi sipas këtij vendimi u ndërpritet edhe atyre punonjësve që thirren për punë dhe nuk pranojnë të punojnë.

9. E drejta e trajtimit 1 (një ) vjeçar, me pagë minimale, sipas pikës 2 të këtij vendimi u njihet edhe atyre punonjësve që shpëputen nga ky trajtim për të punuar për një periudhë jo më shumë se 1(një) vit në sektorin e bakrit, ku ata kanë punuar më parë.

10. Fondi prej 12.31 milionë lekësh në muaj (74 milionë për vitin 2000 dhe 74 milionë lekë për vitin 2001), për trajtimin e punonjësve që humbasin vendin e punës si pasojë e ristrukturimit të industrisë së bakrit, që përfshihen në këtë vendim, do të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, i vitit 2000, i cili i jepet Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale. Për vitin 2001 fondi

të parashikohet në buxhetin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.

11. Paguesa e Punonjësve që dalin të tepërt nga zbatimi i këtij vendimi do të bëhet nga zyrat e punës në rrethet përkatëse.

12. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrin udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**V E N D I M**  
**Nr. 374, datë 14.7.2000**

**PËR RRIJTJEN E PAGËS MINIMALE, NË SHKALLË VENDI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e zëvendëskryeministrit e ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik dhe fizik, vendas ose i huaj bëhet 7 018 lekë.

2. Vendimi nr.203, datë 22.4.1999, i Këshillit të Ministrave, “Për rritjen e pagës minimale në shkallë vendi”, shfuqizohet.

3. Vendimi i shtrin efektet financiare nga 1.7.2000.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**V E N D I M**  
**Nr.375, datë 14.7.2000**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.437, DATË 3.9.1993, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË TATIMEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e zëvendëskryeministrit e ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin nr.437, datë 3.9.1993, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime.

a) Në pikën 1, paga mujore për funksionet e mëposhtëme bëhet:

Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Këshilltar i plotfuqishëm, i ngarkuar për bashkërendimin ndërmjet organeve të policisë tatimore dhe doganore 56 760 lekë

b) në pikën 2, paga mujore për funksionin e zëvendësdrejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme

të Tatimeve bëhet 40 535 lekë.

c) Në pikën 3 niveli më i ulët i pagës bëhet 8 470 lekë në muaj, kurse niveli më i lartë (kryetar dege, drejtor drejtorie), bëhet 22 385 lekë në muaj.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen, në përputhje me pikën 1, të aktit normativ nr.1, datë 14.7.2000, “Për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga rritja e pagave dhe pensioneve”.

3. Vendimi i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2000.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr.376, datë 14.7.2000**

**PËR RITJEN E PAGAVE TË GJYQTARËVE DHE TË PROKURORËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në nenit 4, të ligjit nr.7800, datë 2.3.1994, “Për pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektivë dhe prokurorëve”, ndryshuar me ligjin nr.8082, datë 7.3.1996, me propozimin e zëvendëskryeministrit e ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1.Pagat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve rriten në masën 10 për qind, sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen në përputhje me pikën 1, të aktit normativ nr.1, datë 14.7.2000, “Për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga rritja e pagave dhe pensioneve”.

3. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 1.7.2000.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

**PASQYRA 1**  
**PAGA MUJORE E PUNONJËSVE TË PROKURORIVE**

**1.1. Në Prokurorinë e Përgjithshme**

1. Prokuror i përgjithshëm	91960 lekë
2. Prokuror i Gjykatës së Lartë	68970 “
3. Prokuror (drejtor drejtorie)	55363 “
4. Prokurorë të Prokurorisë së Përgjithsh.	52635

**1.2. Në Prokurorinë e Apelit**

1.Prokuror Apeli	55363 lekë
2.Zëvendësprokuror Apeli	52635 “

3.Prokuror 47190 “

1.3. Në Prokurorinë e rrethit Tiranë

1.Prokuror rrethi 52635 lekë

2.Zëvendës Prokuror rrethi 47190 “

3.Prokuror 43560 “

4. Oficer i policisë gjyqësore 37752 “

1.4. Në prokuroritë e rretheve

1. Prokuror rrethi 47190 lekë

2. Zëvendësprokuror rrethi 43560 “

3. Prokuror 39930 “

4. Oficer i policisë gjyqësore 37510 “

PASQYRA 2  
PAGA MUJORE E GJYQTARËVE

2.1. Në gjykatën e Apelit Civil dhe në Gjykatën Ushtarake të Apelit

1. Kryetar 68970 lekë

2. Zëvendëskryetar 57838 “

3. Gjyqtarë 54450 “

2.2. Në gjykatën e rrethit Tiranë

1. Kryetar 54450 lekë

2. Zëvendëskryetar 48103 “

3. Gjyqtarë 44473 “

2.3. Në gjykatat e rretheve

1. Kryetar 48103 lekë

2. Zëvendëskryetar 44473 “

3.Gjyqtarë 41745 “

PASQYRA 3  
PAGAT E INSPEKTORIATIT PRANË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

3.1. Kryeinspektorë dhe inspektorë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë

1. Kryeinspektor 68970 lekë

2. Zëvendëskryeinspektor 57838 “

3. Inspektor 54450 “

**V E N D I M**  
**Nr.377, datë 14.7.2000**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.194, DATË 22.4.1999, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE TË PUNONJËSVE  
MËSIMORË, NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr.8467, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e zëvendëskryeministrit e ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Pagat e punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar rriten 10 për qind.
  2. Në vendimin nr.194, datë 22.4.1999, të Këshillit të Ministrave, lidhja nr.I, “Struktura e pagës së punonjësve mësimorë“, lidhjet nr.2 dhe nr.3, “Shpërblimi mujor për punonjësit mësimorë në arsimin parauniversitar, që punojnë larg vendbanimit”, zëvendësohen me lidhjet, me të njëjtin numër, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
  3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi fillojnë nga data 1.7.2000 përballohen në përputhje me pikën 1, të aktit normativ nr.1, datë 14.7.2000, “Për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga rritja e pagave dhe pensioneve”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
	PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E PROFESIONIT	
	Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për Pozicion (SHP)	Totali
Drejtor shkollës së mesme Përgjegjës poligoni Dr.Inst.të Nxën.që nuk shikojnë Drejt.Inst.të nxën. që nuk dëgjojnë Dr. në Shkollat me PLM Drejtor i Konvikteve	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	10 273 lekë	Nga ... lekë Deri ... lekë
Zv/Dr. në shkollë të mesme Dr.i Shkollës 8-vjeçare Zv/Dr. në inst.e nx.që nuk shikojnë e dëgjojnë dhe shkollat me PLM. Dr.i Qendr.Kult.të Fëmijëve Përgjegjës i bazës prodhuese	1	2% e PG për çdo vit pune	5% e PG 10% e PG 20% e PG	9 020 lekë	Nga ... lekë Deri ... lekë
Dr. i shkollës fillore (klasa e I-IV) Përgj.(kryemësues) i shk.	1	“	“	7 837 lekë	Nga ... lekë

me klasë kolektive Zv/Dr. i shk. 8-vjeçare Përgj.sekt në Qend.Kult.Fem.					Deri ... lekë
Dr. i Kopshtit me Ushqim	1	“	“	6 850 lekë	“
Dr. i Kopshtit pa Ushqim	1	“	“	5 702 lekë	“
Mësues në shkollat e mesme Mësues në Shk. së Ulët Profesionale Mësues në Inst. E Nx. që nuk shikojnë e dëgjojnë dhe Shk. me PLM.	1	“	“	7 214 lekë	Nga ... lekë Deri ... lekë
Mësues në Shk.8-vjeçare (I- VIII) Edukatore Konvikti. Kujdestar Konvikti. Instruktur në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	“	“	6 292 lekë	Nga ... lekë Deri ... lekë
Edukatore në Kop.Fëmijësh.	1	“	“	5 192 lekë	“
Mësues në shk.të mes. dhe 8-vjeçare	3	“	“	6 292 lekë	
Eduktor në kop. fëmijësh.	3	“	“	5 192 lekë	“

#### LIDHJA NR.2

Grupi	Paga në lekë
1.	6 600 lekë
2.	5 500 lekë
3.	4 950 lekë
4.	3 300 lekë

#### LIDHJA NR.3

#### SHPËRBLIMI MUJOR PËR PUNONJËSIT MËSIMORE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR QË PUNOJNË LARG VENDBANIMIT

Mësuesit që punojnë larg vendbanimit të tyre marrin shpërblim, si vijon:

- Kur punojnë brenda rrethit të tyre por larg vendbanimit dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre deri në 1 067 lekë, kur nuk kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre deri në 3 200 lekë
- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre, në rrethet Pukë, Tropojë, Kukës, Has, Malësi e Madhe, Dibër, Bulqizë, deri në 4 270 lekë kur punojnë në qytetet dhe në qendër të rrethit, dhe deri në 5 330 lekë kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.
- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre të vendbanimit në rrethet Mat, Mirditë, Gramsh, Librazhd, deri në 3 200 lekë kur punojnë në qytet dhe në qendër, dhe deri 4 270 lekë kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.
- 3 200 lekë kur punojnë në qytet dhe në qendër, dhe deri 4 270 lekë kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.
- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre të vendbanimit në rrethet e tjera deri në 2 130 lekë kur punojnë në qytete dhe në qendrën e rrethit, dhe deri 3 200 lekë kur punojnë jashtë qytetit e qendrës së rrethit.

**V E N D I M**  
**Nr. 378, datë 14.7.2000**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 393, DATË 3.9.1992, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999, “ Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I :**

1. Pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore rriten mesatarisht në masën 10 për qind.  
2. Pagat e punonjësve të sistemit të shëndetësisë, të cilët paguhen me lidhjen nr.II, “Paga bazë sipas klasave”, duke filluar nga klasa V (e pestë) deri në klasën XIV (katërmbëdhjetë) rriten në masën 15 për qind.

3. Në vendimin nr.393, datë 3.9.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja I, “Pagat mujore të titullarëve të organeve të larta shtetërore, institucioneve të tjera qendrore dhe pagat e personave të barazvlefshëm me ta”, dhe lidhja nr. 2. “Klasifikimi i pagave të punonjësve të administratës së lartë shtetërore, institucioneve qendrore dhe funksionarëve të pushtetit lokal”, zëvendësohen me lidhjen që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Në lidhjet përkatëse të niveleve të pagave mujore, sipas funksioneve të tjera në Presidencë, në Kuvend, në Këshillin e Ministrave, në ministri dhe në institucione të tjera qendrore, bëhen ndryshimet sipas tabelave me të njëjtin numër, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

b) Lidhja II, “Paga bazë sipas klasave” dhe lidhja II/M, “Paga bazë sipas klasave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore, ATSH, prefekturave dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar”, si dhe lidhja nr. II “Pagat bazë sipas klasave për punonjësit e shëndetësisë” zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër,që i bashkëlidhen këtij vendimi.

c) Pika 11 ndryshohet si vijon:

“ Punonjësve të jashtëm, që japin mësim në shkollat e larta, për çdo orë mësimi u jepen 286 lekë”.

ç) Pika 12 ndryshohet si vijon:

“ Punonjësve të jashtëm, inxhinierë, ekonomistë, agronomë, etj, që japin mësim në shkollat e mesme, në shkollat e ulta profesionale dhe në kurset e ndryshme (me përjashtim të kurseve që ngrihen pranë shkollave të larta, pranë Institutit Pedagogjik dhe Drejtorisë së kualifikimit të kuadrit të arsimit), për çdo orë mësimore u jepen 160 lekë”.

d) Pika 16 ndryshohet si vijon:

“Punonjësit mësimorë, që, për nevoja të procesit mësimor, japin orë mësimi mbi normën mësimore vjetore ( të lejuar me dispozitë ) paguhen, për çdo orë mësimore, në shkollat e larta 286 lekë, në shkollat e mesme 160 lekë dhe në shkollat 8- vjeçare 132 lekë”.

e) Në pikën 17, për emërtimet që vijojnë, paga bazë mujore bëhet:

- Akademik	45 980 lekë
- Profesor, drejtues kërkimesh	37 510 lekë
- Asistent profesor, mjeshtër kërkimesh	31 460 lekë

Për punonjësit që nuk janë efektivë në shkollat e larta ose në institucionet kërkimore shkencore, po janë bashkëpunëtorë në veprimtaritë e tyre, si dhe punonjësit efektivë të shkollave të larta, që nuk janë pedagogë (janë nëpunës), shpërblimi, sipas emërtesave që vijojnë, të jetë:

- Profesor, drejtues kërkimesh	4 840 lekë
--------------------------------	------------

- Asistent profesor, mjeshtër kërkimesh 4 235 lekë
- Për gradën shkencore, doktor i shkencave 3 630 lekë

4. Në lidhjen II- A, “Shtesa mbi pagë për funksione drejtuese”, bëhen këto ndryshime:

a. Në shkronjën “ç”, në paragrafin e dhjetë, ku bëhet fjalë për punonjësit e inspektimit të Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike dhe të Inspektoriatit të Punës, pas “Drejtori 10 për qind”, shtohet “Zëvendësdrejtori 10 për qind”.

b. Në fund të shkronjës “ç”, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Shefi i sektorit dhe specialistët e Drejtorisë së Punësim-Pagave, në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale marrin një shtesë, për natyrë të veçantë pune, në masen 30 për qind mbi pagën bazë”.

c. Në shkronjën “i”, pas fjalëve “drejtuesit dhe specialistët në sistemin e Ministrisë së Financave” të shtohet fjala “dhe punonjësit e tjerë”.

ç. Pas shkronjës “k”, shtohet shkronja “l”, me këtë përmbajtje:

“Drejtesit dhe specialistët e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimi dhe të Administratës së Përgjithshme të Ndihmës, të cilët paguhen sipas lidhjes II-M, marrin një shtesë, për natyrë të veçantë pune, deri në 30 për qind, sipas përcaktimit që do të bëjë ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale”.

5. Në pikën 1 të vendimit nr. 328, datë 26.1.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin ekonomik- financiar të efektivit të njësisë së transportit mjekësor me helikopter”, pagat bëhen si vijon:

- Përgjegjësi i njësisë së transportit me helikopter 17 600 lekë
- Pilot helikopteri 14 080 lekë
- Teknik helikopteri 12 342 lekë
- Mjek 12 342 lekë
- Infermier i ndihmës së shpejtë i njësisë së transportit me helikopter 8 712 lekë

6. Në pikën 2, të vendimit nr. 406, datë 19.6.1995, të Këshillit të Ministrave “Për forcimin e rrjetit hidrometeorologjik dhe sizmologjik”, paga për vrojtuesit bëhet 2 420 – 3 025 lekë.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendim, përballohen në përputhje me pikën 1, të aktit normativ nr.1, datë 14.7.2000, “Për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga rritja e pagave dhe pensioneve”.

8. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2000.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

**Ilir Meta**

#### LIDHJA I RENDITJA E FUNKSIONEVE SIPAS PLANIFIKIMIT

A1 Presidenti	145 200
A2 Kryeministër	133 100
A3 Zëvendëskryeministër. Zëvendëskryetar i Kuvendit.	102 850
A4 Ministër	96 800
A5 Kryetar i Akademisë së Shkencave. Deputet	90 750
A6 Kryetar i Komitetit të Zhvillimit të Turizmit	84 700
A7 Sekretar i Përgjithshëm në Presindencë. Sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Ministrave. Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit. Kancelar i Gjykatës së Lartë.	78 650
A8	72 600

A9 Prefekt i Tiranës Kryetar i Bashkisë së Tiranës.	66 550
A10 Shef Kabineti në Presidencë. Drejtor Kabineti në Këshillin e Ministrave. Shef Kabineti në Kuvend. Zëvendësministër	64 350
A11 Këshilltar i Presidentit. Këshilltar i Kryeministrit. Këshilltar i Kryetarit të Kuvendit. Zëdhënës i Presidentit. Zëdhënës i Kryeministrit. Zëdhënës i Kryetarit të Kuvendit.	62 920
A12 Sekretar i përgjithshëm në ministri. Kryetar i Komitetit Shtetëror për Kontrollin e Figurave të zyrtarëve. Prefekt. Drejtor i Përgjithshëm i RTV. Drejtor i ATSH. Drejtor i Administratës Publike. Ndihmës i Presidentit. Ndihmës i Kryeministrit. Këshilltar i Zëvendëskryeministrit. Kryetar i Agjensisë Kombëtare të Energjisë. Kryetar i Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve. Zëvendëskryetar i Komitetit të zhvillimit të Turizmit. Kryetar i Komitetit Shtetëror për Kultet. Kryetar i Agjensisë Kombëtare të Mjedisit. Zëvendëskryetar, Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave.	61 710
B1 Grupi i parë i Drejtorëve të Drejtorive (Departamenteve) në varësi të Presidencës, Këshillit të Ministrave, Kuvendit. Drejtor Departamenti në Presidencë , Këshillin e Ministrave, në Kuvend. Drejtor Departamenti në Ministri. Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes. Këshilltar i Kryesisë së Kuvendit. Ndihmës i zëvendëskryeministrit. Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve.	56 870
B2 Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme në Ministri dhe në varësi të Ministrive. Drejtor i Drejtorisë së Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Drejtor i Drejtorisë së Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë. Shef i Kabinetit të Ministrit. Jurist në Departamentin Juridik në Presidencë, Këshillin e Ministrave dhe në Kuvend. Përfaqësues ligjor pranë organizmave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Përfaqësues i zyrës së minoriteteve.	54 450
B3 Grupi i Dytë i Drejtorëve të Drejtorive në varësi të Presidencës, Këshillit të Ministrave, të Kuvendit. Drejtor Drejtorie në Presidencë, në Këshillin e Ministrave, në Kuvend. Këshilltar i Ministrit. Këshilltar në komisionin Parlamentar. Këshilltar në Kuvend. Zëvendëskryetar i Bashkisë së Tiranës. Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i RTSH. Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit në Ministrinë e Drejtësisë. Drejtor i Radios së Jashtme, Drejtor i Radios së Brendëshme. Drejtor i Televizionit. Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Burgjeve. Kryetar i Këshillit të Rrethit Tiranë. Akademik. Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit në Ministri.	45 980

<p>B4 Kryetar i Këshillit në Rrethet e Kategorisë së parë.  Kryetar i Bashkisë së Kategorisë së parë.  Sekretar i Përgjithshëm i Prefekturës.  Shef i Zyrës së Pritjes së Popullit në Presidencë, në Këshillin e Ministrave, në Kuvend.  Përgjegjës Sektori në Presidencë, në Këshillin e Ministrave në Kuvend.  Drejtor i Përgjithshëm në Bashkinë e Tiranës.  Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë së Tiranës.  Profesor, drejtues kërkimesh, kryeinspektor i shërbimit të inspektoriatit të përgjithshëm financiar në Ministrinë e Financave.  Inspektor në Drejtorinë e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë.  Inspektor i Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes.  Zëvendës drejtor në Drejtorinë e Inspektimit dhe Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë.  Zëvendës drejtor i grupit të parë të drejtorive (Departamenteve) në varësi të Presidencës, të Këshillit të Ministrave, të Kuvendit.  Zëvendës drejtor i Drejtorive të Përgjithshme në varësi të Ministrive.  Zëvendës drejtor i ATSH.  Kryeinspektor i inspektoriatit në Ministrinë e Pushtetit Lokal .  Këshilltar i Kryetarit të Komitetit të Zhvillimit të Turizmit.  Drejtor Drejtorie në Ministri.  Drejtor në burgje dhe institucione riedukimi.  Drejtor i Institutit të Monumenteve të Kulturës.  Drejtor i Bibliotekës Kombëtare.  Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar.  Drejtor i Galerisë Kombëtare të Arteve.  Drejtor i Teatrit të Operas dhe Baletit.  Drejtor i Teatrit Kombëtar.  Rektor.  Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit në Prefekturë, Përgjegjës sektori dhe përgjegjës i zyrës së kontrollit në ministri.</p>	37 510
<p>C1 Sekretar i Presidentit. Sekretar i Kryeministrit. Sekretar i Kryetarit të Kuvendit.</p>	31 460
<p>C2 Sekretar i Zëvendëskryeministrit. Sekretari i Zëvendëskryeministrit të Kuvendit  Sekretar teknik në Kabinetin e Presidentit, e Kryeministrit, Kryetarit të Kryesisë së Kuvendit  Redaktor, Bibliograf, Përkthyes, Stenograf, Asistent, Inxhinier, Inspektor, Ekonomist, Specialist,  në Presidencë, Këshillin e Ministrave, në Kuvend.  Inspektor Kontrolli në Drejtoritë e Kontrollit, në Prefektura</p>	27 830
<p>C3 Sekretar i Ministrit. Sekretar i Komisionit Parlamentar.  Sekretar i Sekretarit të Përgjithshëm në Presidencë, në Këshillin e Ministrave, në Kuvend.  Përgjegjës sektori në Komitetin e Zhvillimit të Turizmit.  Sekretare e Kryetarit të Komitetit të Zhvillimit të Turizmit.</p>	24 200

#### LIDHJA NR.2

#### KLASIFIKIMI I PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS SË LARTË SHTETËRORE, INSTITUCIONEVE QENDRORE DHE FUINKSIONARËVE NË PUSHTETIN LOKAL

A1	145 200
A2	133 100
A3	102 850
A4	96 800
A5	90 750

A6	84 700
A7	78 650
A8	72 600
A9	66 550
A10	64 350
A11	62 920
A12	61 710
B1	56 870
B2	54 450
B3	45 980
B4	37 510
B5, C1	31 460
C2	27 830
C3	24 200

**LIDHJA II**  
**PAGA BAZË SIPAS KLASAVE**

Nr.	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1.	I	7018
2.	II	7260
3.	III	7590
4.	IV	7865
5.	V	8 168
6.	VI	8 470
7.	VII	8 894
8.	VIII	9 416
9.	IX	9 862
10.	X	10 164
11.	XI	10 577
12.	XII	12 029
13.	XIII	14 350
14.	XIV	17 111

**LIDHJA II/M**  
**PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT E MINISTRIVE, INSTITUCIONEVE TË TJERA QENDRORE, ATSH, PREFEKTURAVE DHE SHËRBIMI GJEOLGJIK SHQIPTAR.**

Nr.	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1.	I	7 986
2.	II	8 470
3.	III	8 712
4.	IV	9 416
5.	V	10 285
6.	VI	11 011
7.	VII	12 463
8.	VIII	14 784

9.	IX	15 807
10.	X	19 437

LIDHJA II – 4  
NIVELET E PAGËS SIPAS FUNKSIONEVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Nr.	EMËRTIMI	KLASIFIKIMI
1.	Kryeministër .....	A2
2.	Zëvendëskryeministër .....	A3
3.	Sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Ministrave.....	A7
4.	Drejtor Kabineti në Këshillin e Ministrave .....	A10
5.	Këshilltar i Kryeministrit.....	A11
	Zëdhënës i Kryeministrit.....	
6.	Drejtor i Administratës Publike.....	A12
	Ndihmës i Kryeministrit.....	
	Këshilltar i Zëvendëskryeministrit.....	
7.	Grupi i parë i drejtorëve të drejtorive (departamenteve) në varësi të Këshillit të Ministrave.....	
	Drejtor Departamenti në Këshillin e Ministrave.....	
	Ndihmësi i Zëvendëskryeministrit.....	B1
8.	Jurist në Departamentin Juridik në Këshillin e Ministrave....	B2
9.	Grupi i Dytë i drejtorëve të Drejtorive në varësi të Këshillit të Ministrave.....	
	Drejtor Drejtorie në Këshillin e Ministrave.....	
	Shef Protokolli .....	B3
10.	Shef i Zyrës së Pritjes së Popullit.....	
	Përgjegjës Sektori në Këshillin e Ministrave.....	
	Zëvendësdrejtor i Grupit të parë të Drejtorive në varësi të Këshillit të Ministrave.....	B4
11.	Zëvendësdrejtor i Grupit të dytë të Drejtorive në varësi të Këshillit të Ministrave.....	B5
12.	Sekretar i Kryeministrit .....	C1
13.	Sekretar i Zëvendëskryeministrit.....	
	Sekretar teknik në Kabinetin e Kryeministrit.....	
	Redaktor. Bibliograf. Përkthyes. Stenograf. Asistent. Inxhinier. Inspektor. Ekonomist.....	C2
	Specialist.....	
14.	Sekretar i Sekretarit të Përgjithshëm .....	C3

Nr.	EMËRTIMI I PUNONJËSIT	Niveli i pagës Klasa	Shtesë për funksion (grupi)
1.	Përgjegjës Arkivi. Përgjegjës Administrate.....	IX	4
2.	Përgjegjës i teknikës së shumëfishimit.....	VIII	3
3.	Arkivist. Llogaritar i parë.....	VIII	
4.	Përgjegjës Ofiçine .....	VII	1
5.	Punonjës shtypshkronje. Daktilografist. Arkëtar.		

	Dekorator. Fonist. Teknik mirëmbajtje.	VII
	Magaznier.....	
6.	Punëtorë të tjerë. Shofer .....	V
7.	Punëtor Pastrimi .....	III

**LIDHJA II-5**  
**NIVELI I PAGAVE PËR PUNONJËSIT E MINISTRIVE**  
**DHE INSTITUCIONEVE TË TJERA QENDRORE**

Nr.	EMËRTIMI	KLASIFIKIMI
1.	Ministër .....	A4
2.	Kancelar në Gjykatën e Lartë .....	A7
3.	Zëvendësministër.....	A10
4.	Kryetar i Komisionit shtetëror për Kontrollin e Figurave të Zyrtarëve.....	
	Drejtor i Përgjithshëm i Radiotelevizionit Shqiptar.....	
	Drejtor i ATSH.....	
	Kryetar i Agjensisë Kombëtare të Energjisë.....	
	Kryetar i Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunik.....	
	Kryetar i Agjensisë Kombëtare të Mjedisit.....	
	Sekretar i përgjithshëm në Ministri .....	A12
5.	Drejtor Departamenti në Ministri.....	B1
6.	Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme në Ministri, dhe në varësi të ministrive.....	
	Drejtor i Drejtorisë së Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme .....	
	Drejtor në Drejtorinë e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë.....	
	Shef i Kabinetit të Ministrit.....	
	Anëtar i Këshillit Drejtues të Entit Rregull të Telekomunikacionit .....	B2
7.	Këshilltar i Ministrit.....	
	Këshilltar Juridik në Gjykatën e Lartë.....	
	Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit në Ministrinë e Drejtësisë	
	Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit në ministri.....	B3
8.	Kryeinspektor i Inspektoriatit të Përgjithshëm Financiar në Ministrinë e Financave.....	
	Zëvendësdrejtor në Drejtorinë e Inspektimit dhe Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë.....	
	Inspektor në Drejtorinë e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë.....	
	Kryeinspektor i Inspektoriatit në Ministrinë e Pushtetit Lokal.....	
	Zëvendësdrejtor i Drejtorive të Përgjithshme në varësi të Ministrive.....	
	Drejtor Drejtorie në ministri.....	
	Zëvendësdrejtor i ATSH.....	
	Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit në Prefekturë, përgjegjës sektori dhe përgjegjës i zyrës së kontrollit, në ministri .....	B4
9.	Drejtor i Drejtorisë teknike në RTV.....	

	Drejtor i Drejtorisë ekonomike në RTV.....	
	President i Këshillit Kombëtar të Urdhërit të Mjekut.....	
	Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit në Ministrinë e Drejtësisë.....	
	Inspektor në Inspektoriatin e Përgjithshëm Financiar në Ministrinë e Financave.....	
	Zëdhënës i Ministrit.....	
	Zëdhënës i Gjykatës së Lartë.....	
	Inspektor në Inspektoriatin në Ministrinë e Pushtetit Lokal	
	Inspektor i Kontrollit në Ministri.....	B5
10.	Inspektor i Kontrollit në Drejtoritë e Kontrollit në Prefektura.....	C2
11.	Sekretar i Ministrit.....	C3

Nr.	EMËRTIMI I PUNONJËSIT	Niveli i pagës Klasa	Shtesë për funksion (grupi)
12.	Drejtor i Drejtorisë. Sekretar i Komisionit të Kualifikimit Shkencor .....	X	6
13.	Shëf Sektori. Kryetar dege.....	IX	5
13/1	Përgjegjës Zyre.....	IX	3
14.	Sekretar i Këshillit Kombëtar të Urdhërit të mjekut... Sekretar i Këshillit Kombëtar të Punës.....		
	Kryesekretar i Shkollës së Magjistraturës.....	X	
15.	Specialist i parë. Inspektor i parë.....	VIII	
16.	Specialist i dytë. Inspektor i dytë.....	VII	
17.	Përgjegjës administrate.....	VI	1
18.	Shfuqizuar.....		
19.	Sekretar i titullarëve të tjerë dhe të zëvendësministrave.....	VII	
20.	Kryellogaritar..... Sekretar i Zv/Prokurorit të Përgjithshëm.....	VI	
21.	Përkthyes..... Referent ligjshmërie në Gjykatën e Kasacionit.....	VI	
22.	Arkivist.....	VI-VII	
23.	Përgjegjës ofiçine e transporti.....	V	1
24.	Llogaritar i parë.....	V	
25.	Operator i terminaleve.....	V	
26.	Shofer.....	IV	
27.	Magaznier..... Llogaritar.....	IV	
28.	Daktilografiste.Sekretare.Shaptilografiste.Fotokopjues e.Arkëtar.....	IV	
29.	Punëtor.....	II-IV	

**V E N D I M**  
**Nr.379, datë 14.7.2000**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.185, DATË 16.4.1993, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR PAGAT DHE SHITESAT MBI PAGË TË USHTARAKËVE TË  
SHËRBIMIT PYJOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e zëvendëskryeministrit e ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe ministrit të Financave , Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin nr.185, datë 16.4.1993, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:  
a) Në pikën 1, paga mujore për funksionet e mëposhtëme bëhet:

Drejtor	56 760 lekë
Zëvendësdrejtor	40 535 lekë

b) Në pikën 2, niveli më i ulët i pagës bëhet 7 018 lekë në muaj, kurse niveli më i lartë (drejtor drejtorie), bëhet 22 385 lekë në muaj.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen në përputhje me pikën 1, të aktit normativ nr.1, datë 14.7.2000, “Për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga rritja e pagave dhe pensioneve”.

3. Vendimi i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2000.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr. 380, datë 14.7.2000**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.358, DATË 28.7.1999, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE TË  
DOGANAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës” dhe të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999, “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit e ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

I. Në vendimin nr.358, datë 28.7.1999, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pagat e punonjësve të doganave rriten 10 për qind.

2. Në fund të pikës “I”, shtohen një paragraf me këtë përmbajtje:

a) Paga e drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave bëhet 56 760 lekë në muaj.

b) Paga e zëvendësdrejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave bëhet 40 530 lekë në muaj.

3. Lidhja nr.I, “Struktura e pagës së doganave” dhe Lidhja nr.2, zëvendësohen me lidhjet, me të njëjtin numër, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

II. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen në përputhje me pikën 1, të aktit normativ nr.1, datë 14.7.2000, “Për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga rritja e pagave dhe pensioneve”.

III. Vendimi i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2000.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Ilir Meta**

K A T E G O R I A	PAGA MUJORE				
	PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E PROFESIONIT	
	EMËRTIMI	Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi në %	Shtesa për Kualifikim në %	Shtesa për Pozicion në lekë
A. Drejtor Drejt. në Departament Drejtor Drejtorie Rajonal	1	2% e PG për çdo vit pune		24 739	15 466
B. Përgjegjës sektori Kryetar Dege Inspektor	1	2% e PG për çdo vit pune		19 606	13 690
C1. Specialist, Hetues dogane Drejtues Turni	1	2% e PG për çdo vit pune		12 373	12 905
C2. Doganier	1	2% e PG për çdo vit pune		9 747	10 944
D1. Doganier, shofer, regjistruar, sekretar, magazinier, operator, laborant.	3	2% e PG për çdo vit pune		7 948	8 771
D2. Centralist. Sportelist	3	2% e PG për çdo vit pune		7 948	8 771
Sanitare. Punëtor mirëmbajtje	4	2% e PG për çdo vit pune		4 565	1 699

LIDHJA NR.2

Grupi	Paga në lekë
1.	6 600 lekë
2.	5 500 lekë
3.	4 950 lekë
4.	3 300 lekë

**V E N D I M**

**Nr.381, datë 14.7.2000**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.440, DATË 9.9.1999, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR STRUKTURËN DHE PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË  
NDËRTIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e zëvendëskryeministrit ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në vendimin nr.440, dtë 9.9.1999, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pagat e punonjësve të Policisë së Ndërtimit rriten në masën 10 për qind.
  2. Tabelat nr.2, “Pasqyra e pagave për punonjësit e Drejtorisë së Policisë së Ndërtimit në qendër” dhe “Pasqyra e pagave për punonjësit e degëve të Policisë së Ndërtimit në rrethe” zëvendësohen me tabelat me të njëjtin numër, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
  3. Niveli më i ulët për ushtarakët e Policisë së Ndërtimit bëhet 8 470 lekë në muaj, kurse niveli më i lartë (kryetar dege), bëhet 22 385 lekë në muaj.
  4. Vendimi nr.238, datë 16.4.1996, i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në pagat e Policisë së Ndërtimit”, shfuqizohet.
  5. Efektet financiare, që rrjedhin nga miratimi i këtij vendimi, përballohen në përputhje me pikën 1, të aktit normativ nr.1, datë 14.7.2000, “Për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga rritja e pagave dhe pensioneve”.
  6. Vendimi i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2000.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**TABELA NR.2**  
**PASQYRA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË**  
**SË POLICISË SË NDËRTIMIT NË QENDËR**

Nr.	EMËRTIMI	KLASA	PAGA NË LEKË
1.	Drejtor		56760
2.	Zëvendësdrejtor		40535
3.	Kryetar Dege	XXII	22385
4.	Shef Sektori	XXII	22385

5.	Kryetar Dege Gadishmërie	XXII	22385
6.	Specialistë	XXI	20158
7.	Shofer	IX	12898
8.	Punonjës Grupi Gadishmërie	XIX	18065
9.	Arkivist Daktilografist Protokollist	VI	11446
10.	Magaznier	VI	11446
11.	Sekretare Daktilografiste	VI	11446
12.	Punonjës Shërbimi	III	10255
13.	Pastruese	I	8470

**TABELA NR.2**  
**PASQYRA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË**  
**SË POLICISË SË NDËRTIMIT NË RRETHE**

Nr.	EMËRTIMI	KLASA	PAGA NË LEKË
1.	Kryetar Dege K1	XXII	22385
2.	Kryetar Dege K2	XXI	20 158
3.	Shef Sektori	XXI	20158
4.	Specialist i Lartë	XX	19012
5.	Specialist i Mesëm	VIII	11331
6.	Kryetar Grupi Gadishmërie	XXI	20158
7.	Specialist Grupi Gadishmërie	XIX	18065
8.	Arkiv Protokoll	VI	11446
9.	Shofer	IX	12898

**V E N D I M**  
**Nr.382, datë 14.7.2000**

**PËR RRIJTJEN E NIVELIT TË PAGESËS SË PAPUNËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 54, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Niveli bazë i pagesës së papunësisë bëhet 3 100 lekë në muaj.
  2. Efektet financiare, që rrjedhin nga miratimi i këtij vendimi, përballohen nga fondi i miratuar për vitin 2000 për Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.
  3. Vendimi i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2000.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr.384, datë 14.7.2000**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.112, DATË 18.3.1999, “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” DHE TË LIGJIT NR.7870, DATË 13.4.1994, “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë“, dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë“, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.112, datë 18.3.1999, “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.3.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë“ dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

A. Kreu II “Shuma bazë e përfitimeve” ndryshohet si vijon:

1. Në kuptim të neneve 2,32,36 dhe 48, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, shuma bazë e pensioneve nga data 1.7.2000 e në vazhdim është 5 148 lekë në muaj.

2. Në kuptim të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, për personat që nuk plotësojnë kushtet për përfitim të masës së pensionit të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, niveli i pensionit, nga data 1.7.2000 e në vazhdim, është 1 328 lekë në muaj.

B. Në kreun III bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si vijon:

“Shuma minimale mujore e kontributeve për të gjitha degët e sigurimit, për periudhën 1.7.2000 e në vazhdim, është 3 568 lekë”.

2. Fjalía e dytë, në pikën 2 ndryshohet si vijon:

“Për të punësuarit, punëdhënësi derdh kontribut të detyrueshëm në masën 45.9 për qind të listëpagesave, në kufijtë e pagës mujore minimale 7 773 lekë dhe maksimale 23 319 lekë, duke filluar nga data 1.7.2000 e në vazhdim”.

3. Pika 3 ndryshohet si vijon:

“Për vetëpunëdhënësit privatë dhe të vetëpunësuarit (duke përjashtuar të vetëpunësuarit në bujqësi) derdhin kontribut të detyrueshëm në masën 41.5 për qind të pagës mujore minimale 7 773 lekë, duke filluar nga data 1.7.2000 e në vazhdim”.

4. Paragrafi i dytë i pikës 4 ndryshohet si vijon:

“Punonjësit e papaguar të familjes, që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin dhe personat me të ardhura të rregullta nga pronësia, me moshë mbi 16 vjeç, që nuk kanë ndonjë punësim tjetër, paguajnë kontribut të sigurimit shëndetësor në masën 7 për qind të pagës mujore minimale 7 773 lekë dhe maksimale 23 319 lekë, duke filluar nga data 1.7.2000 e në vazhdim”.

5. Paragrafi i tretë i pikës 6 ndryshohet si vijon:

“Të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë vetë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, një herë në tri muaj.”.

6. Paragrafi i fundit i pikës 6 ndryshohet si vijon:

“Të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë, së bashku me kontributet e sigurimeve shoqërore, kontributet e detyrueshme për sigurimet shëndetësore në masën 5 për qind të pagës minimale mujore prej 900 lekësh, e barabartë me 45 lekë në muaj. Rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë e Tropojë, masën e kontributit e kanë 3 për qind të pagës minimale mujore prej 900 lekësh, e barabartë me 27 lekë në muaj.”.

7. Efektet financiare të këtij vendimi shtrihen nga data 1 korrik 2000.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**V E N D I M**  
**Nr.385, datë 14.7.2000**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.381, DATË 20.5.1996, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN E STATUSIT TË INVALIDIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Në pikën 2 të vendimit nr.381, datë 20.5.1996, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e statusit të invalidit” bëhet ky ndryshim: “Shtesat mujore, që u jepen invalidëve si përfitim paaftësie, rriten në masën 15 për qind.”.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 8.1 milionë lekë dhe përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Plani i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për vitin 2000, në zërin “Shpenzime”, i shtohen 8.1 milionë lekë.
4. Vendimi i shtrin efektet financiare duke filluar nga data 1.7.2000.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**V E N D I M**  
**Nr.386, datë 14.7.2000**

**PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996,, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, si dhe të nenit 1, të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Përfitimet suplementare të ushtarakëve, të atyre që janë caktuar dhe të atyre që do të caktohen deri në datën 30.6.2000 (përfshirë edhe kjo datë), në mbështetje të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ

Shtetëror” (i ndryshuar), rriten në masën 10 për qind.

2. Pensionet familjare, ato që janë caktuar dhe që do të caktohen deri në datën 30.6.2000 (përfshirë edhe kjo datë), në mbështetje të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit, rriten në masën 10 për qind.

3. Efektet financiare nga rritja e përfitimeve suplementare të ushtarakëve llogariten në shumën 41 500 mijë lekë dhe përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Efektet financiare, nga rritja e pensioneve familjare të familjeve në ngarkim të pilotëve, që kanë humbur jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit, llogariten në shumën 480 mijë lekë dhe përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

5. Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2000 në zërin “Shpenzime”, i shtohen 41 980 mijë lekë.

6. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Banka e Kursimeve dhe Alba Post sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**V E N D I M**  
**Nr.387, datë 14.7.2000**

**PËR RITJEN E PENSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë“, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Pensionet e caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1996, “Mbi sigurimet shoqërore shtetërore në Republikën e Shqipërisë“ dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë“ (i ndryshuar), me përjashtim të pensioneve të caktuara sipas nenit 96, paragrafi i katërt i ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, ndryshon si vijon:

2. Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme, pensionet për merita të veçanta dhe pensionet për vjetërsi shërbimi, me masë pensioni mujor:

- deri në 4 400 lekë rriten 17 për qind.

- nga 4 401 lekë deri në 4 556 lekë bëhen 5 148 lekë.

- nga 4 557 lekë deri në 5 242 lekë rriten 13 për qind.

- nga 5 243 lekë deri në 5 385 lekë bëhen 5 923 lekë.

- mbi 5 386 lekë e lart rriten 10 për qind.

3. Pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare rriten në masën 15 për qind.

4. Pensionet shtetërore të posaçme dhe shtesa e pensioneve të posaçme shtetërore rriten në masën 10 për qind.

5. Shtesa mujore e përfitur nga vendimi nr.326, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, rriten në masën 10 për qind.

6. Rritjen në masën e mësipërme e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen, duke filluar nga data 30.6.2000 duke përfshirë edhe këtë datë.

7. Pensioni i plotë i pleqërisë dhe pensioni i plotë i invaliditetit, duke filluar nga data 1.7.2000 e në vazhdim, nuk mund të caktohen më pak se 5 148 lekë në muaj.

8. Pensionet e caktuara sipas dekretit nr.758, datë 1.2.1994, "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut" rriten në masën 15 për qind.

9. Pensionet e caktuara sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972, si dhe pensionet e caktuara, sipas paragrafit të katërt të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, (i ndryshuar), rriten në masën 15 për qind.

10. Pensioni i plotë i pleqërisë dhe pensioni i plotë i invaliditetit, që caktohet sipas paragrafit të katërt të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, duke filuar nga data 1.7.2000 e në vazhdim nuk llogariten më pak se 1 328 lekë në muaj.

11. Efektet financiare nga rritja e pensioneve janë 1 645 milionë lekë dhe përballohen nga:

- fondi i sigurimeve shoqërore i miratuar në buxhetin e vitit 2000, në shumën 1 043.5 milionë lekë.

- teprica e fondit të sigurimeve shoqërore e vitit 1999 në shumën 226 milionë lekë.

- fondet e planifikuara për koston e ristrukturimit të bankave në shumën 375.5 milionë lekë.

12. Institutit të Sigurimeve Shoqërore në zërin "shpenzime", i shtohen 601.5 milionë lekë.

13. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Banka e Kursimeve për zbatimin e këtij vendimi dhe nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse.

14. Për përballimin e vëllimit të punës, për rritjen e pensioneve, Institutit të Sigurimeve Shoqërore i shtohen në fondin e pagesës 3 milionë lekë, të cilat të përballohen brenda buxhetit të shpenzimeve administrative të tij në vitin 2000.

15. Vendimi i shtrin efektet financiare, nga data 1.7.2000.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Ilir Meta**

## **U D H Ë Z I M**

**Nr.3, datë 14.7.2000**

### **PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 18.3.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR ZBATIMIN E VENDIMIT NR.112, DATË 18.3.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJIT NR.7703, DATË 11.5.1993, "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" DHE TË LIGJIT NR.7870, DATË 13.10.1994, "PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e zëvendëskryeministrit e ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

## **U D H Ë Z O N:**

Në udhëzimin nr.1, datë 18.3.1999, të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime:

1. Kreu I i udhëzimit ndryshohet si vijon:

"Për zbatimin e pikës 1, të kreut III, të vendimit nr.112, datë 18.3.1999, të Këshillit të Ministrave, kontributet minimale mujore, sipas degëve të sigurimit, për punëmarrësit dhe për efekt të sigurimit vullnetar të personave të tjerë janë:

Pas datës 1 korrik

- Dega e sigurimit të sëmundjeve

117 lekë

- Dega e sigurimit të barrës së lindjes

218 lekë

- Dega e sigurimit të pensioneve

2 464 lekë

- Dega e sigurimit të aksidenteve dhe të sëmundjeve profesionale	39 lekë
- Dega e sigurimit të papunësisë	466 lekë
- Dega e sigurimit shëndetësor	264 lekë
<b>Shuma:</b>	<b>3 568 lekë</b>

2. Në kreun II, shtohen këto paragrafe:

“Në bazë të Kodit të Punës, punëdhënësi duhet të ketë lidhur kontratën individuale me punëmarrësit e tij, ndërsa në zbatim të vendimit nr.594, datë 22.12.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për regjistrin që mban punëdhënësi për punëmarrësit e tij”, duhet të mbajë regjistrin e evidentimit të punës dhe dokumente të tjera, që vërtetojnë pagën e punëmarrësve, për çdo muaj. Në bazë të këtyre dokumenteve punëdhënësi harton listëpagesat mujore dhe i paraqet ato, sipas formatit tip, në organet e sigurimeve shoqërore.

Për ndërprerjet e punës apo për ditët e munguara në punë, do të vepohet:

- Mungesat në punë për arsye shëndetësore do të justifikohen me raportin mjekësor, të paraqitur.

- Ndërprerjet në punë do të justifikohen nga akti i mbajtur nga punëdhënësi mbi shkaqet e ndërprerjes në punë.

- Për rastet e fillimit të punës apo të largimit të punonjësve gjatë muajit, saktësimi i tyre do të mbështetet në regjistrin që mban punëdhënësi si dhe në deklarinimin e tij pranë organeve të sigurimeve shoqërore.

Në këto kushte për ditët e munguara do të bëhen llogaritjet përkatëse për secilin punëmarrës dhe konkretisht, paga mujore, brenda kufijve (7 773-23 319 lekë) do të pjesëtohet me ditët e punës së muajit të caktuar në kontratë. Në këtë mënyrë del paga ditore, e cila duke u shumëzuar me 45.9 për qind, jep kuotën ditore për efekt të kontributeve të sigurimit shoqëror dhe atij shëndetësor. Ditët e punuara duke shumëzuar me këtë kuotë ditore japin shumën e kontributeve mujore të këtij punëmarrësi”.

3. Në kreun III shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“ Të vetëpunësuarit, të cilëve me vendim gjykate u është njohur e drejta për të punësuar persona, të cilët nuk janë pjesëtarë të familjes së tij apo ortakë me të, janë të detyruar të zbatojnë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga marrëdhëniet punëdhënës-punëmarrësi dhe të zbatojnë kriteret e kreut II, të këtij udhëzimi.

4. Efektet e këtij udhëzimi fillojnë më datën 1 korrik 2000.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

#### NDREQJE GABIMI

Në Fletoren Zyrtare Nr.19, Korrik 2000, Ligji nr.8633 datë 3.07.2000, Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Kredisë për Zhvillim “Projekti i Reformës Ligjore dhe Gjyqësore”” ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), në faqen 924, neni 6, rreshti i parë pika a:

është: reformën dhe me aftësitë prokuruese, financiare, menaxhuese/paguese të përshtatshme, si dhe me ambiente zyrash dhe pajisje të përshtatshme që do t’i sigurohen NjZP-së, dhe

bëhet: NjZP të formohet zyrtarisht brenda Ministrisë së Drejtësisë me aftësi përkatëse për reformën dhe me aftësitë prokuruese, financiare, menaxhuese/paguese të përshtatshme, si dhe me ambiente zyrash dhe pajisje të përshtatshme që do t’i sigurohen NjZP-së, dhe

U dorëzua për shtyp më 19.7.2000  
Doli nga shtypi më 19.7.2000

Tirazhi: 3700 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 200 lekë